

ALBERTO MORAVIA  
**MĚRZIA**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



Alberto Moravia

# Mërzia

Roman

*Përkthet nga origjinali italisht:*

Erion Gjatolli

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2015

Autori: Alberto Moravia  
Titulli në origjinal: La Noia  
Botuar në italisht nga: Bompiani

Questo libro è stato tradotto grazie ad un contributo alla traduzione assegnato dal Ministero degli Affari Esteri Italiano.

Ky libër u përkthye falë kontributit për përkthim të akorduar nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktore: Anrila Spahija  
Korrektore letrare: Arlinda Rrushhi  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Albana Gega

ISBN 978-9928-205-06-3

© Bompiani / RCS Libri. S.p.A., Milan, 1983-2014

© *në shqip* Botimet Toena, 2015

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)  
[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## PROLOG

E mbaj mend mirë arsyen pse e lashë pikturën. Një mbrëmje, pasi kisha ndenjur tetë orë me radhë në studion time, herë duke pikturuar për pesë apo dhjetë minuta e herë duke u lëshuar mbi divan i shtrirë me sytë nga tavani për një ose dy orë, papritur, pas shumë përpjekjeve të lëmekura, si i harlisur nga një frymëzim më në fund i vërtetë, shtypa cigaren e fundit në taketuken e mbushur me bishta të fikur, bëra një hedhje si të felinëve prej kolltukut ku isha kredhur, rrëmbeva një biçak që përdorja ndonjëherë për të kruar ngjyrat dhe, me goditje të përsëritura, e zhagmita pa u ndalur kanavacën që po pikturoja, derisa e bëra fërtele. Pastaj mora nga një cep i dhomës një kanavacë të pastër, po aq të madhe, hodha atë të grisurën dhe vura të renë në trekëmbësh. Sakaq vura re se ai gjest shkatërrues, i furishëm e, gjithsesi, racional, ma shteri të gjithë energjinë, si të thuash... krijuese. E kisha punuar atë pikturë gjatë dy muajve të fundit pareshtur, me këmbëngulje; tekefundit, ishte si ta kisha përfunduar duke e shqyer me thikë, ndoshta

me pasoja të dëmshme për rezultatet e jashtme, që nuk më interesonin shumë, por ishin, gjithsesi, të dobishme për frymëzimin tim. Kësisoj shkatërrimi i pikturës tregonte se kisha mbërritur në përmbylljen e një diskutimi të gjatë, të nisur me veten prej kushedi sa kohësh. Tregonte se më në fund kisha shkëlur në tokë të qëndrueshme. Kështu, kanavaca e pastër, që tanimë qëndronte mbi trekëmbësh, nuk ishte vetëm një kanavacë e çfarëdoshme, ende e papërdorur, por bash ajo kanavacë që kisha vënë mbi trekëmbësh në fund të një pune të gjatë. Pra, siç mendova duke mëtuar të lehtësoj veten nga ndjesia tronditëse që më rrokte në fytyrë, duke u nisur nga ajo kanavacë, në dukje e ngjashme me shumë të tjera, por që për mua ishte e ngarkuar me domethënie dhe rezultate, tani mund t'ia nisja lirisht nga e para; sikur ato dhjetë vjet pikturë të mos kishin kaluar dhe unë të isha ende njëzet e pesë vjeç, si atëherë kur lashë shtëpinë e mamasë për të jetuar në studion në rrugën “Margutta”, për t’iu përkushtuar me rehati pikturës. Por, nga ana tjetër, kanavaca e pastër, që tani qëndronte mbi trekëmbësh, tregonte një zhvillim jo më pak intim dhe të nevojshëm, tërësisht negativ, që, mes kalimesh të pandjeshme, më kishte shpënë drejt pafuqisë së plotë. Që kjo pandehje e dytë të ishte ajo e vërteta, vërtetohej nga fakti se mërzia kishte shoqëruar ngadalë dhe pa asnjë dyshim të gjithë punën time gjatë gjashtë muajve të fundit, për ta ndaluar tërësisht atë pasdite që kisha lakanisur kanavacën; pak a shumë si fundërrimet gëlqerore të disa burimeve që bllokojnë tubat, duke ndaluar plotësisht kalimin e ujit.

Mendoj se në këtë pikë do të ishte e rastit që të thosha ndonjë fjalë për mërzinë, një ndjenjë për të cilën do të flas shpesh në këto faqe. Kështu, për aq sa kujtesa më lejon të kthehem prapa ndër vite, mbaj mend ta kem vuajtur gjithmonë mërzinë. Vetëm se duhet të kuptohemi për këtë fjalë. Për shumë njerëz, mërzia është e kundërta e zbavitjes; ndërsa zbavitja është shpengim, harresë. Ndërsa për mua mërzia nuk është e kundërta e zbavitjes, madje mund të them se, përkundrazi, nga disa anë, ajo i përngjan zbavitjes duke qenë se shkakton shpengim dhe harresë, ndonëse të një lloji shumë të veçantë. Mërzia, për mua, është pikërisht një lloj pamjaftueshmërie ose papërshtatshmërie, ose mangësie e realitetit. Për të përdorur një metaforë, kur mërzitem, realiteti më jep ndjesinë turbulluese që i shkakton, në një natë dimri, mbulesa tejet e shkurtër një njeriu në gjumë: e ul te këmbët dhe ndien të ftohtë në kraharor, e ngre në kraharor dhe ndien të ftohtë në këmbë; e kështu nuk arrin kurrë të bjerë në gjumë. Ose, tjetër krahasim, mërzia ime i përngjan ndërprerjes së shpeshtë e të mistershme të rrymës elektrike në një shtëpi: një çast çdo gjë është e qartë, këtu janë kolltukët, divanet, e më tej dollapët, raftet, pikturat, perdet, tapetet, dritaret, dyert; një çast më vonë ka vetëm terr dhe zbrazëti. Ose, krahasimi i tretë, mërzia ime mund të përcaktohet si sëmundje e sendeve, që është një vdirrje ose humbje e gjallërisë thujse të papritur; si të shohësh në pak sekonda, me shndërrime të shpejta e të njëpasnjëshme, një lule që kalon nga çelja në vshkje dhe bëhet pluhur.

Ndjesia e mërzisë lind tek unë nga absurditeti i realitetit, që, siç thashë, është i pamjaftueshëm e i paaftë për të më bindur për ekzistencën e tij. Për shembull, mund të më ndodhë të shikoj me vëmendje një gotë. Derisa t'i them vetes se kjo gotë është një enë kristali ose metali e prodhuar për të nxënë një lëng e për ta çuar në buzë pa e derdhur, pra, derisa të jem në gjendje të përfytyroj me bindje gotën, do të më duket se kam me të një marrëdhënie të çfarëdoshme, aq sa të bindem për ekzistencën e saj dhe, për rrjedhojë, edhe për timen. Por mendoni sikur gota të flashket e të humbasë gjallëri, siç thashë më parë, pra të më shfaqet si diçka e huaj, me të cilën s'kam asnjë marrëdhënie, me një fjalë, të më shfaqet si diçka absurde dhe, atëherë, nga ky absurditet do të marrë shkas mërzia që, tani mund ta them, s'është tjetër veç pamundësi komunikimi dhe paftësi për t'i shpëtuar. Por kjo mërzi, në vetvete, nuk do të më mundonte shumë sikur të mos dija se, edhe pa pasur marrëdhënie me gotën, ndoshta edhe mund të kem, domethënë që gota ekziston në ndonjë parajsë të panjohur në të cilën sendet nuk reshtin kurrë për asnjë çast së qeni sende. Mërzia, pra, përtej pamundësisë që të dal nga vetja, është vetëdija teorike se mund të dal nga kjo gjendje, falë, nuk di ç'mrekullie.

Thashë se jam mërzitur gjithmonë; shtoj se vetëm këto kohët e fundit kam arritur të kuptoj me qartësi çfarë është në të vërtetë mërzia. Gjatë fëmijërisë, e më pas gjatë adoleshencës dhe rinisë, e kam vuajtur mërzinë pa i dhënë shpjegim, si ata që kanë dhimbje koke të vazhdueshme, por nuk bëhen mbarë të shkojnë



të vizitohen te mjeku. Sidomos kur isha fëmijë, mërzia merrte forma krejtësisht të errëta ndaj vetes sime dhe të tjerëve, që unë s'isha në gjendje t'i shpjegoja dhe që të tjerët, në këtë rast mamaja ime, e justifikonin me probleme shëndetësore apo shkaqe të tjera të ngjashme; pak a shumë siç shpjegojmë grindjet e foshnjave me daljen e dhëmbëve. Më ndodhte në ato vite ta ndërprisja lojën papritmas e të qëndroja me orë të tëra pa lëvizur, si i shtangur, i mposhtur nga ligështia që më shkaktonte ajo që quajta vdirrje e sendeve, domethënë nga vetëdija e errët se mes meje dhe sendeve nuk kishte asnjë marrëdhënie. Nëse mamaja hynte në dhomë në ato çaste e, duke më parë të pafjalë, të palëvizshëm e të zbehur prej vuajtjes, më pyeste se çfarë kisha, dhe unë përgjigjesha gjithmonë: “Po mërzitem”; duke shpjeguar kështu, me një fjalë, me kuptim të qartë e të angësht, një gjendje shpirtërore të thellë e të errët. Kështu, duke i marrë seriozisht fjalët e mia, mamaja ulej të më përqafonte e mandej më premtonte se do të më çonte në kinema po atë ditë, pra më parashtronte një zbatimje që, siç e dija tashmë mjaft mirë, nuk ishte e kundërta e mërzisë dhe as çlirimi prej saj. Ndërsa unë, duke e shtirur gëzimin për premtimin, nuk e shmangia dot po atë ndjesi mërzie që mamaja mëtonte të davaritte, për buzët e saj që ndalonin mbi ballin tim, për krahët e saj që më pushtonin shpatullat, si dhe për kinemanë që ajo më buthtonte si një mirazh përpara syve. Edhe me buzët e saj, me krahët saj, me kinemanë nuk kisha asnjë marrëdhënie në atë çast. Por si t'ia shpjegoja mamasë që nuk kishte lenim për ndjesinë e mërzisë që më

kaplonte? Kam vënë re se mërzia përkon kryesisht me pamundësinë e komunikimit. Tani, në pamundësi për të komunikuar me mamanë time, ndaj së cilës ndieja të njëjtën largesë si ndaj çdo sendi tjetër, në njëfarë mënyre isha i shtrënguar të pranoja keqkuptimin dhe ta gënjeja.

Nuk po ndalem në tronditjet që më shkaktoi mërzia gjatë adoleshencës. Asokohe, rezultatet e dobëta në mësimet u përlligjën me të ashtuquajturat “dobësi”, domethënë paaftësi të lindura në këtë apo atë lëndë shkollore; dhe unë vetë e pranoja këtë shpjegim, në pamundësi për të gjetur një më të vlefshëm. Ndërsa tashmë e di me siguri se notat e dobëta që më vinin në çdo fundviti shkollor, kishin një arsye të vetme: mërzinë. Në të vërtetë, unë ndieja thellësisht, me angështinë e ngahershme, se nuk kisha asnjë marrëdhënie me atë pështjellim të pamasë mbretërisht athinas dhe perandorësh romakë, lumenjsh të jugut të Amerikës dhe malesh të Azisë, të njëmbëdhjetërrrokëshave të Dantes e të gjashtërrrokëshave të Virgjilit, të veprimeve algjebrike e formulave kimike. Gjithë kjo sasi e pamatshme nocionesh nuk më përkiste, ose më përkiste vetëm sa për të diktuar absurditetin e tyre themeltar. Por, siç thashë më parë, nuk krenohesha as me vete e as me të tjerët për këtë ndjesi timen kaq të dëmshme; në të kundërt, mendoja se nuk duhej ta ndieja e as ta vuaja. Më kujtohet se që atëherë kjo vuajtje më ngjalli një dëshirë për ta qëmtuar e për ta shpjeguar. Vetëm se unë isha një djalosh me pedanteri dhe ambicie karakteristike djaloshare. Për rrjedhojë, përfundimi ishte një projekt historie universale sipas mërzisë, nga i cili shkrova

vetëm faqet e para. Historia universale sipas mërzi së mbështetej në një ide tejet të thjeshtë: jo në progresin, në evolucionin biologjik, në faktorin ekonomik; asnjëra prej arsyeve që zakonisht parashtrojnë historianët e shkollave të ndryshme; zembereku i historisë ishte mërzia. I këndellur nga ky zbulim i mrekullueshëm, ia nisa punës prej fillimit. Në fillim, pra, ishte mërzia, e quajtur rëndom kaos. Zoti, i mërzitur nga mërzia, krijoi tokën, qiellin, ujin, kafshët, bimët. Adami dhe Eva, edhe këta të mërzitur në parajsë, hëngrën frutën e ndaluar. Zoti u mërzit me ta dhe i përzuri nga Edeni; Kaini, i mërzitur me Abelin, e vrau; Noeja, i mërzitur keqas, shpiku verën; Zoti, i mërzitur sërish nga njerëzit, shkatërroi botën me një përmbytje; por kjo e mërziti akoma më shumë, aq sa e hapi sërish motin. E kështu me radhë. Perandoritë e lashta egjiptiane, babilonase, persiane, greke dhe romake lindnin nga mërzia dhe rrëzoheshin po nga mërzia; mërzia e paganizmit sillte krishterimin; mërzia e krishterimit sillte paganizmin; mërzia e katolicizmit, protestantizmin; mërzia e Europës çonte në zbulimin e Amerikës; mërzia e feudalizmit shkaktonte Revolucionin Francez; ndërsa mërzia e kapitalizmit, Revolucionin Rus. Të gjitha këto zbulime i shënova në një pasqyrë të vogël; më pas, me zell të madh, nisa të shkruaj historinë e plotë. Nuk mbaj mend mirë, por s'besoj të kem shkruar më tej përshkrimin shumë të hollësishëm të mërzi së së kobshme që mundonte Adamin dhe Evën në Eden, të cilët, pikërisht për shkak të kësaj mërzie, kryen mëkatin original. Atëherë, i mërzitur edhe unë prej projektit tim, e lashë me kaq.

Në të vërtetë, gjatë gjithë jetës sime, e kam vuajtur më shumë mërzinë gjatë moshës dhjetë deri në njëzet vjeç. Kam lindur në vitin 1920, kështu, adoleshenca ime kaloi nën vellon e zezë të fashizmit, domethënë të një regjimi politik që e kishte bërë sistem mungesën e komunikimit, si të diktatorit me masën, ashtu edhe të qytetarëve me njëri-tjetrin dhe me diktatorin. Mërzia, që është mungesë e marrëdhënieve mes gjërave, gjatë fashizmit ishte edhe në ajrin që thithnim; kësaj mërzie shoqërore i duhet shtuar mërzia e nevojave të topitura seksuale që, siç ndodh në atë moshë, më pengonte komunikimin me po ato gra me të cilat pandehja se po i shfryja. Por mërzia më shpëtoi nga Lufta Civile, që pak më vonë do të rrëronte Italinë për dy vjet; më saktësisht, në këtë mënyrë: ndodhesha në ushtri, në një divizion të vendosur në Romë; me t'u shpallur armëpushimi, hoqa uniformën dhe u ktheva në shtëpi. Më pas doli thirrja me urdhrin për të rikthyer të gjithë oficerët në ushtri, në të kundërt parashikohej dënimi me vdekje. Mamaja, me përruljen karakteristike ndaj autoriteteve, që në atë periudhë ishin fashiste dhe gjermane, më këshilloi të vishja uniformën dhe të paraqitesha në komandë. Ajo donte shpëtimin tim; në të vërtetë më shtynte drejt deportimit e ka gjasa, edhe drejt vdekjes në kampet naziste të përqendrimit, siç ndodhi me shumë nga shokët e mi të luftës. Ishte mërzia, dhe vetëm mërzia, pra pamundësia për të vendosur një marrëdhënie të çfarëdollojshme mes vetes dhe asaj thirrjeje, mes vetes dhe uniformës, mes vetes dhe fashistëve, mërzia që kisha vuajtur gjatë njëzet viteve e që tani e bënte të

paqenë në sytë e mi perandorinë e lavdishme të liktorit dhe kryqit të thyer që më shpëtoi. Pavarësisht lutjeve të mamasë, u strehova në fshat, në vilën e një mikut tim dhe atje kalova gjithë periudhën e Luftës Civile, duke pikturuar, një mënyrë e çfarëdoshme kjo për të kaluar kohën. Kështu u bëra piktor, domethënë shpresova të rivendosja njëherë e përgjithmonë marrëdhënien me realitetin përmes shprehjes artistike. Madje, në lehtësimet e para që shkaktoi ngazëllimi për pikturën, gati u binda se mërzia që kisha ndier deri atëherë s'kishte qenë tjetër veç mërzia e një artisti që nuk e dinte se ishte i tillë. Gabohesha, por për ca kohë pandeha se kisha gjetur shpëtim.

Në fund të luftës u ktheva te mamaja, që ndërkohë kishte blerë një vilë të madhe në rrugën "Appia". Kisha shpresuar, si thashë më parë, që piktura të kishte çrrënjësuar mërzinë, por thuajse menjëherë kuptova se nuk ishte kështu. M'u rikthyen, pra, vuajtjet e mërzisë, pavarësisht pikturës; madje, duke qenë se mërzia ndërpriste vetvetiu pikturimin, vura re forcën dhe shpeshësinë e së keqes sime të vjetër me saktësinë më të madhe se kur nuk pikturoja. Kështu, problemi i mërzisë u përshfaq sërish, i pandryshuar, atëherë unë nisa të pyes veten se cili ishte shkaku, e me rregull përjashtimi, mbërrita në përfundimin se ndoshta mërzitesha sepse isha i pasur dhe se po të kisha qenë i varfër nuk do të isha mërzitur. Ky mendim nuk ishte kaq i qashtë në mendjen time asokohe, sa ç'është tani në letër; më shumë se një mendim, bëhej fjalë për dyshimin e ngulët se kishte një lidhje të padyshimtë ndonëse të errët mes

mërzisë dhe parasë. Nuk dua të flas gjatë për këtë periudhë fort të papëlqyeshme të jetës sime. Duke qenë se mërzitesha, e kur mërzitesha nuk vizatoja, nisa të urrej me gjithë shpirt vilën e mamasë dhe rehatinë që kisha; i vishja vilës së mamasë mërzinë time e për rrjedhojë pamundësinë për të pikturuar, duke mëtuar largimin. Por meqë bëhej fjalë, siç thashë, për një dyshim, nuk mund t'ia thosha hapur mamasë të vetmen gjë që do të kisha dashur t'i thosha: nuk dua të jetoj me ty, sepse je e pasur dhe pasuria më mërzit, dhe mërzia nuk më lejon të pikturoj. Në të kundërt, mundohesha vetvetiu të bëhesha i padurueshëm, që të lija të kuptohej e, në njëfarë mënyre, ta bëja të detyrueshëm largimin tim nga vila. I kujtoj ato ditë si ditë pakënaqësie të përhershme, kryeneqësie dashakeqe, refuzimi kokëfortë, gati antipatie të sëmurë. Nuk jam sjellë kurrë aq keq me mamanë sa në atë kohë; kështu, mërzisë që më shtrëngonte, i shtohej mëshira për mamanë, që nuk arrinte t'i jepte shpjegim vrazhdësisë sime. Por kryekreje vuaja një lloj paralize të të gjitha aftësive të mia, kështu, i pagojë, i plogët dhe i topitur, më dukej sikur isha i murosur i gjallë brenda vetes, si brenda një burgu të padepërtueshëm e mbytës.

Qëndrimi në vilë dhe gjendja ime shpirtërore do të kishin vazhduar shumë më gjatë sikur, për fat, mamaja të mos shikonte te mërzia ime të njëjtën ndjenjë që kish prishur marrëdhëniet e saj me babanë tim. Kësisoj, erdhi çasti të flasim edhe për të, qoftë edhe kalimthi, sikur vetëm për arsye se më ka paraprirë në rrugëtimin drejt mërzisë.

Im atë, pra, ishte një endacak i lindur, me ç'kam pasur mundësinë të qëmtoj, domethënë, një nga ata burra që, në shtëpi, me kalimin e kohës, bien në heshtje, u pritet oreksi dhe, kështu, refuzojnë të jetojnë, pjesërisht, sepse janë si ata zogjtë që nuk durojnë dot në kafaz; e që pastaj, kur ndodhen në kuvertën e anijes ose në vagonin e trenit, rimarrin gjithë gjallërinë e humbur. Ishte i gjatë, atletik, biond e me sy të kaltër, si unë; vetëm se unë nuk jam i bukur, sepse më kanë rënë flokët para kohe, kam fytyrë të ngrysur e të zymtë; ndërsa ai po, të paktën duke u zënë besë lëvdatave të mamasë, e cila kish dashur të martohej me të me çdo kusht, megjithëse ai ia përsëriste vazhdimisht se nuk e donte e se do ta linte sa më parë. E kisha parë pak herë, sepse udhëtonte shpesh dhe herën e fundit që e pashë flokët e verdhë ishin thujse gri dhe fytyra e tij mikluese ishte prerë nga rrudha të holla e të thella, por mbante akoma kravatat e shkujdesura flutur dhe kostumet me kuadrate të rinisë. Shkonte e vinte, domethënë ikte nga mamaja ime, sepse me të mërzi tej e pastaj kthehej sërish, ka mundësi vetëm për të marrë paratë për një arratisje tjetër, sepse nuk kishte asnjë kacidhe, sido që merrej me “import-eksport”. Derisa nuk u kthye më. Një rribë ere në detin e Japonisë përmbysi një *ferry-boat* me qindra pasagjerë dhe im atë u mbyt me ta. Nuk e mora vesh kurrë a ishte në Japoni për “import-eksportet” e tij, apo për arsye të tjera. Sipas mamasë, që parapëlqente përcaktimet shkencore, ose që duken të tilla, im atë vuante nga *dromomania*, domethënë nga mania për të lëvizur. Ndoshta, komentonte mendueshëm ajo, nga kjo

mani merrte shkas edhe pasioni për pullat, dokumente të vogla të ngjyrosura me larminë e paanësinë e botës, me të cilat kishte krijuar një koleksion që ajo ende e ruante, si dhe zotësia në gjeografi, e vetmja lëndë që kishte studiuar me të vërtetë në shkollë. Siç mendoj se e kam bërë të qartë, mamaja ime e quante *dromomaninë* e babait si diçka tërësisht individuale, e megjithatë, të parëndësishme, ndërsa unë s’kisha si të mos ndieja një lloj mëshire vëllazërore për atë figurë patetike dhe të venitur, gjithmonë e më të venitur me kalimin e kohës, në të cilën më bëhej sikur përshquaja, të paktën për sa i përket marrëdhënies së tij me mamanë, disa tipare të përbashkëta me veten. Por ishin tipare të jashtme, siç do të kuptoja më vonë, duke e rrahur me mend: vërtet im atë kishte vuajtur edhe ai mërzinë, por tek ai kjo mërzi ishte zgjidhur me një endje të lumtur nëpër vende; mërzia e tij, më fjalë të tjera, ishte mërzia e rëndomtë, siç e kuptojmë zakonisht, që nuk kërkonte më shumë se të lenohej me ndjesi të reja e të rralla. E kështu, babai kishte pasur besim te bota, të paktën te gjeografia, ndërsa unë nuk arrija të besoja as në një gotë uji.

Gjithsesi, mamaja nuk humbi në përsiatje dhe pandehu se përshqoi, pa dyshim, në mërzinë time, bezdinë sipërfaqësore që ia kishte vështirësuar marrëdhëniet me të shoqin: “Për fat të keq, i ke ngjarë më shumë babait se mua”, më tha në fund, një ditë, nxitimthi. “Unë e di se kur ju kap, e vetmja zgjidhje është t’ju largosh. Prandaj nisu, shko ku të duash, e kur të të kalojë, kthehu!”



U përgjigja menjëherë i çliruar, që s'kisha ndër mend të nisësja: udhëtimi nuk më ngjallte aspak interes. Dëshiroja vetëm të ikja nga shtëpia, të jetoja për hesapin tim. Mamaja u përgjigj se ishte marrëzi të dilja më vete, kur kisha në dispozicion një vilë të madhe si ajo ku banonim, ku, për më tepër, bëja si të doja. Por unë, tashmë i vendosur për të përfutuar nga ky rast, u përgjigja dhunshëm se do të ikja që të nesërmen e s'do të qëndroja as edhe një orë më shumë. Kështu mamaja e kuptoi se isha i vendosur. S'i mbeti tjetër veç të përsëriste me hidhërim të regjur se në përgjigjen time shquante, madje, edhe tonin e zërit të babait: të bëja, pra, atë që më shumë më pëlqente, të shkoja të jetoja ku të kisha dëshirë.

Mbetej çështja e parave. Ishim të pasur, siç thashë më parë, e deri atëherë unë kisha pasur në dispozicion një kredit, si të thuash, të pakufizuar: tërhiqja nga llogaria e mamasë sa herë që kisha nevojë. Mamaja ime, që përfytyronte të përsëriste me mua përvojën me të shoqin, të cilit i jepte aq pará sa të largohej, por asnjëherë mjaftueshëm që të qëndronte larg saj, më paralajmëroi thatë se nga ajo ditë do të më jepte një shumë mujore. Iu përgjigja se nuk dëshiroja asgjë më shumë; e kur më shpërfaqti, gati me një keqardhje të mërishme, shumë që kishte ndër mend të më jepte, e paralajmërova se do të më mjaftonte gjysma. Mamaja, që ishte përgatitur për një bisedë nga ato që bënte dikur me babanë, të cilit paratë nuk i mjaftonin kurrë, u habit nga ky mosinteresim i papritur.

“Nuk jetohet me kaq pak pará, Dino”, shqiptoi gati padashur. Iu përgjigja se ishte puna ime; e për të mos

u hequr si asketik, shtova se gjithsesi shpresoja shumë shpejt të mund ta mbaja veten duke pikturuar. M'u duk sikur mamaja më shikonte me mosbesim; siç e dija, nuk kishte besim në prirjet e mia artistike. Disa ditë më pas gjeta një studio në rrugën “Margutta” dhe u shpërngula atje me plaçkat e mia.

Natyrisht, ndryshimi i vendbanimit nuk solli asnjë ndryshim të gjendjes sime shpirtërore. Dua të them se, pas venitjes së lehtësimit fillestar që shoqëron çdo ndryshim, nisa të mërzitem me të njëjtat intervale si më parë. Thashë “natyrisht”; pikërisht sepse duhej ta kisha parashikuar se mërzia nuk do të zhdukej vetëm duke ndryshuar shtëpi: për më tepër unë isha i pasur, jo sepse banoja në rrugën “Appia”, por sepse zotëroja një sasi të caktuar parash. E nuk kishte hiç rëndësi që unë, në fakt, s’kisha ndër mend t’i përdorja; edhe disa të pasur që janë koprracë, shpenzojnë një pjesë shumë të vogël të të ardhurave dhe bëjnë jetë të varfër; askush nuk do t’i quante për këtë arsye të varfër. Kështu, ai mendimi i parë, ose më saktë ai obsesioni se mërzia ime dhe për rrjedhojë shterpësia në art shkaktonte nga fakti se banoja bashkë me mamanë, ngadalë u zëvendësua nga një fiksion edhe më i rëndë: nuk mund të hiqej dorë nga pasuria; të ishe i pasur ishte si të kishe sy të kaltër ose hundë të kthyer; një vendosmëri e hollë ngërthente të pasurin me paranë dhe i jepte ngjyrën e parave edhe vendosmërisë për të mos e përdorur atë. Me pak fjalë, unë nuk isha një i varfër që kish qenë i pasur, isha thjesht një i pasur që shtirej me veten e me të tjerët se ishte i varfër.

Për vërtetësinë e kësaj, bindja veten në këtë mënyrë: “Çfarë bën një i varfër i vërtetë kur nuk ka pará? Vdes urie. Çfarë do të bëja unë në rast të tillë? Do të shkoja t’i kërkoja pará mamasë. Po edhe sikur të mos ia kërkoja, sërish nuk do të quhesha i varfër; në fakt, do të quhesha thjesht i çmendur”. Por, siç mendova më pas, imi nuk ishte ndonjë rast ekstrem. Ishte një rast i ndërmjetëm, duke qenë se unë pranoja të më mbante mamaja me pará, ndonëse jetoja me gjërat më të domosdoshme. Kështu, përballë të varfërve të vërtetë, e shihja veten në pozitën e privilegjuar dhe të padrejtë të lojtarit të pasur karshi lojtarit të varfër: i pari mund të humbë pafundësisht, i dyti jo. Por, mbi të gjitha, i pari ka, pra, mundësinë “të luajë”, që do të thotë të zbavitet; ndërsa të dytit i mbetet vetëm përpjekja për të fituar.

Është e vështirë të tregoj çfarë ndieja kur mendoja të tilla gjëra. Me një ndjenjë magjie dritëshkurtër kundër së cilës nuk bëja dot asgjë, sepse s’kisha nga ta dija se ku apo si ishte përdorur magjia që më joshte. Ndonjëherë më vinte në mendje shprehja evangjelike: “Është më e lehtë që gamilja të kalojë nëpër vrimën e gjilpërës, se i pasuri të hyjë në mbretërinë e Perëndisë”, dhe pyesja veten se ç’do të thotë të jesh i pasur. Quhesh i pasur nëse zotëron shumë pará? Apo nëse ke lindur në një familje të pasur? Apo nëse ke jetuar dhe vazhdon të jetosh në një shoqëri që e vendos pasurinë mbi çdo të mirë tjetër? Apo sepse beson te pasuria, me dëshirën për t’u bërë i pasur e me keqardhjen se ke qenë i tillë. Apo sepse, si në rastin tim, nuk do të jesh i pasur? Sa më shumë e mendoja, aq më të vështirë e kisha t’ia saktësoja vetes kuptimin e

përcaktimit dhe paracaktimit që më sugjeronte pasuria. Është e qartë se nuk do ta kisha këtë ndjesi sikur ta kisha çliruar veten nga obsesioni im fillestar se mërzia varej nga pasuria, dhe shterpësia në art nga mërzia. Por të gjitha meditimet tona, edhe ato më racionale, marrin shkas nga një anë e errët e ndjenjës. Dhe nga ndjenjat nuk çlirohesh lehtë, siç mund të bësh me idetë: këto shkojnë e vijnë, por ndjenjat mbeten.

Në këtë pikë, dikush mund të vërejë se, në fund të fundit, unë isha thjesht një piktor i dështuar e, si rrallëherë, i ndërgjegjshëm për dështimin tim: vetëm kaq. Saktë, deri diku. Isha pa dyshim i dështuar, por jo sepse nuk dija të pikturoja tablo që t'u pëlqenin të tjerëve, por sepse ndieja se pikturat e mia nuk më lejonin të shprehesh, pra të gënjeja veten se kisha një marrëdhënie me gjërat, domethënë, me një fjalë të vetme, nuk më pengonin të mërzhitesha. Tani, në fund të fundit, kisha filluar të pikturoja pikërisht për t'i shpëtuar mërzhisë. Nëse sërish mërzhitesha, përse vallë pikturoja?

Ika, me sa mbaj mend, nga vila e mamasë në mars të 1947-s; rreth dhjetë vite më vonë grisa me thikë, siç tregova më parë, pikturën time të fundit dhe vendosa të mos pikturoja më. Sakaq, mërzia, që ushtrimi i pikturës në njëfarë mënyre e kishte mbajtur në fre, më kaploi me një dhunë deri atëherë të panjohur. E kam thënë se mërzia ishte në thelb mungesa e marrëdhënies me gjërat; në ato ditë, përveçse me gjërat, m'u duk se ishte edhe mungesë e marrëdhënies me veten. E di se janë gjëra të ndërlikuara për t'u shpjeguar; do të mundohem t'i afrohem me një metaforë: në ditët që pasuan

vendimin për të braktisur pikturën, më ngjasonte vetja me një individ të padurueshëm për arsye të ndryshme, të cilin një udhëtar e gjen në vagonin e tij në fillim të një udhëtimit të gjatë. Vagoni është nga ata të hershmit, pa komunikim me vagonët e tjerë; treni do të ndalojë vetëm në fund të udhëtimit, pra udhëtari është i detyruar të qëndrojë me shokun e urryer deri në fund të rrugëtimit. Në të vërtetë dhe përtej metaforës, mërzia, në ato vite, ndonëse fshehur nën sipërfaqen e zanatit të piktorit, kishte gërryer thellë jetën time, pa lënë kurrëgjë në këmbë; kështu që, pasi e lashë pikturën, unë ndjeva se, pa e vënë re, isha bërë një shpartallinë a një cung i paformë. Tani, siç thashë, ana kryesore e mërziës ishte pamundësia konkrete për të ndenjur me veten time, i vetmi person që s'mund ta hiqja qafe në asnjë mënyrë.

Kështu, ato ditë, një padurim i jashtëzakonshëm mbizotëronte në jetën time. Asgjë nga ato që bëja nuk më pëlqente e nuk më dukej e denjë për t'u bërë; nga ana tjetër, nuk arrija të imagjinoja asgjë që mund të më pëlqente, pra që të më mbante me punë në mënyrë të vazhdueshme. S'bëja gjë tjetër veç hyja e dilja nga studioja sa herë që i jepja vetes një shkak për të mos ndenjur atje: blija cigare që nuk më duheshin, pija një kafe që nuk më pihej, blija një gazetë për të cilën nuk kisha interes, shikoja ndonjë ekspozitë pikture që nuk më ngjallte as kureshtjen më të vogël, e kështu me radhë. Nga ana tjetër, ndieja se këto veprime nuk ishin gjë tjetër veç kamuflime të ankthshme të mërziës; e dija kaq mirë, sa ndonjëherë nuk i shkoja punëve deri në fund dhe, në vend që të blija gazetën ose të rrufisja

kafenë, ose të vizitoja ekspozitën, pasi kisha bërë disa hapa, kthehesha në studion nga kisha dalë pak çaste më parë me aq nxitim. Por në studio, natyrisht, më priste mërzia, e çdo gjë niste nga e para.

Merrja një libër, kisha një bibliotekë të vogël, kam qenë gjithmonë një lëçitës i mirë, por sakaq e lëshoja nga duart: romanet, esetë, poezia, teatri, gjithë letërsia e botës, s'kishte një faqe të vetme që të tërhiqte vëmendjen time. E nga ana tjetër, përse ta bënte? Fjalët janë simbole të sendeve dhe me sendet, siç thashë, gjatë çasteve të mërzisë, unë nuk kisha marrëdhënie. E lëshoja, pra, librin nga duart, ose me vrull të papërmbajtshëm e flakja në një cep dhe i kthehesha muzikës. Kisha një gramafon shumë të mirë, dhuratë e mamasë, si dhe rreth njëqind disqe. Po kush vallë ta ketë thënë se muzika vepron në çfarëdo mënyre, pra dëgjohet natyrshëm, si të thuash, me patjetër, edhe nga njeriu më i pavëmendshëm? Ai që ka thënë diçka të tillë ka thënë diçka të pasaktë. Në të vërtetë, veshët e mi refuzonin jo vetëm të ndiqnin muzikën, por edhe thjesht ta dëgjonin. E kështu, ndërsa zgjidhja diskun, ky mendim më paralizonte: ç'muzikë mund të dëgjohet në çaste mërzie? Atëherë mbyllja gramafonin, hidhesha në divan dhe filloja të mendoja se çfarë mund të bëja.

Ajo që më bënte më shumë përshtypje ishte se nuk doja të bëja gjë prej gjëje, pavarësisht dëshirës së flaktë për të bërë diçka. Çfarëdo gjëje që kisha dëshirë të bëja më paraqitej e shoqëruar me të kundërtën e saj, si binjaku siamez me të vëllanë, dhe kështu nuk doja të merresha me asgjë. Pra, ndieja që nuk doja të takoja

njeri, por as të rrija vetëm; nuk doja të rrija në shtëpi, por as të dilja; nuk doja të udhëtoja, por as të vazhdoja të jetoja në Romë; nuk doja të pikturoja, por as ta lija pikturën; nuk doja të qëndroja zgjuar, por as të flija; nuk doja të bëja dashuri, por as të mos e bëja; e kështu me radhë. Them ndieja, por më saktë do të duhej të thosha se ndieja veç neveri, krupë, lemeri.

Ndonjëherë, ndër këto furi të mërzisë, pyesja veten mos ndoshta dëshiroja të vdisja; ishte pyetje me vend, duke qenë se të jetoja nuk më pëlqente aspak. Por atëherë, me habi, vija re se ndonëse nuk më pëlqente të jetoja, nuk doja as të vdisja. Kështu, dilemat e dyfishta që si në një valle e kobshme më vërtitëshin në mendje, nuk ndalnin as përballë zgjedhjes ekstreme mes jetës dhe vdekjes. Në të vërtetë, siç mendoja ndonjëherë, dëshira ime nuk ishte të vdisja, por të mos vazhdoja të jetoja në këtë mënyrë.





## KAPITULLI I PARË

Pasi u shpërngula në studion në rrugën “Margutta”, ia dola të kaloja neverinë e paarsyeshme dhe gati besëtytnore që më ngjallte vila në rrugën “Appia” e të vendosja një marrëdhënie, le të themi të rregullt me mamanë. Shkoja për drekë tek ajo një herë në javë, sepse e dija që gjatë asaj kohe do ta gjeja vetëm, dhe qëndroja disa orë, duke dëgjuar gjithmonë të njëjtat biseda, që i dija përmendsh, për ato dy gjëra për të cilat kishte interes: botanika, domethënë lulet dhe bimët që kultivonte në kopshtin e saj, dhe punët, të cilave u përkushtohej, mund të them, që nga mosha e arsyes. Mamasë, në të vërtetë, do t’i kish pëlqyer që ta takoja më shpesh, si dhe në orare të tjera, për shembull kur priste miqtë ose njerëzit e shoqërisë së saj, por ngase refuzova me vendosmëri disa ftesa, u duk sikur mamaja iu dorëzua rrallësisë së vizitave të mia. Natyrshëm, ishte një dorëzim i detyruar e i gatshëm për t’u zhdukur që në rastin më të parë. “Një ditë do ta kuptosh”, kishte zakon të thoshte kur fliste për veten në vetën e tretë, që ishte

tek ajo sinjal i një mërie aq të gjallë, saqë dëshironte ta fshihte, “se mamaja jote nuk është një zonjë dosido që t’i shkosh për vizitë me detyrim dhe se shtëpia jote e vërtetë është këtu e jo në rrugën ‘Margutta’”.

Në një nga këto ditë, pak kohë pasi kisha lënë pikturën, shkova te mamaja për vizitën e zakonshme javore. Në të vërtetë ishte një mëngjes pak i veçantë: atë ditë binte përvjetori i lindjes sime dhe mamaja, në rast se e kisha harruar, ma kishte kujtuar që në mëngjes, duke m’i bërë urimet në telefon, me mënyrën e saj burokratike dhe ceremoniale: “Ti mbush sot tridhjetë e pesë vjeç. Të uroj për zemërsisht lumturi dhe sukses!”. Njëmenjë më kishte paralajmëruar se më kishte përgatitur një “surprizë”.

Kështu, nga mesdita, hipa në makinën time të vjetër e të shkallmuar dhe u nisa nëpër qytet me ndjenjën e zakonshme të parehatisë dhe neverisë, që dukej se rritej sa më shumë i afrohesha shtëpisë. Me zemër gjithnjë e më të angështuar mora rrugën “Appia”, ndër qiparisa, pisha dhe gërmadha, përgjatë ledhit me bar. Porta e mamasë ishte në të djathtë, në gjysmë të rrugës “Appia”, dhe si zakonisht unë e kërkoja me sy, gati duke shpresuar, si për ndonjë mrekulli, të mos e gjeja më e të vazhdoja më tej deri në zonën e kështjellave, për t’u kthyer më pas në Romë, në studion time. Por ja, porta e hapur, mund të them, posaçërisht për mua, për të më ndalur e për të më gllabëruar sapo ta kisha kaluar. Ngadalësova, mora kthesën papritmas e, me një tronditje të shurdhët e të butë të rrotave, hyra në rrugicën e shtruar me zhavorr, mes dy rreshtave me

qiparisa. Rrugica ishte disi e përpjetë deri te vila, që dallohej në fund; dhe unë, atëherë, duke parë qiparisat e zinj, të pluhur e të dredhur dhe vilën e kuqe e të ulët, kruspulluar nën qiellin plot re ngjyrë gri, të ngjashme me shuka pambuku të pistë, përsqova në shpirtin tim tmerrin e angësht që më mbërthente sa herë shkoja të takoja mamanë. Një tmerr si ai që të rrok kur je gati të kryesh një vepër kundër natyre, sikur, duke marrë atë rrugicë, të isha kthyer në barkun që më kishte lindur. U mundova ta davaritja këtë ndjesi të pakëndshme regresi, duke i rënë pa pushim borisë për të lajmëruar ardhjen time. Kështu, dera në katin përdhes u hap menjëherë dhe te pragu u shfaq një shërbyese.

Nuk e kisha parë herë tjetër; mamaja, që këmbëngulte të mbante për vilën aq shërbyes sa nuk do të mjaftonin as për një apartament me pesë dhoma, ishte për pasojë e detyruar t'i ndërronte herë pas here. E gjatë, me vithe dhe gjoks të gjerë e të thukët dhe me flokë çuditërisht të shkurtër e të prerë keq, si flokët e të dënuarve ose të sëmurëve, ajo kishte në fytyrën e zbehtë e pak pikaloshë një shprehje dinake, ndoshta për shkak të syzeve tejet të mëdha e të zeza që i mbulonin sytë. Sidomos më ra në sy goja, me formën e një luleje të shtypur, me ngjyrën rozë delikate të barbarozës. E pyeta ku ndodhej mamaja dhe ajo më pyeti me zë shumë të ëmbël:

- Jeni zoti Dino?

- Po.

- Zonja është në kopsht, në krahun e serrave.

Shkova në atë drejtim; jo pa i hedhur më parë një sy plot habi një makine tjetër që ndodhej në vendin pranë

makinës sime. Një makinë sportive, e ulët dhe e thukët, me tavan të lëvizshëm, ngjyrë të kaltër me shkëlqim. Mamaja, pra, kishte ftuar dikë për mëngjes? Duke bluar me mendje këtë dyshim të pakëndshëm, i rashë rrotull vilës, përgjatë trotuarit me tulla, nën hijen e dafinave dhe aheve, dhe dola në krahun tjetër. Këtu gjeronte një kopsht i stilit italian, me lehe në formë trekëndore, katrore ose rrethore, me fidanë të krasitur në formë të rrumbullakët, piramide dhe ovale, si dhe shumë rrugina e rrugica të shtruara me zhavorr dhe të rrethuara me bush. Një rruginë më e gjerë, e drejtë, e mbrojtur nga një pjergullore prej hekuri, e lyer me të bardhë, rreth së cilës mbështilleshin degët e hardhisë, ndante në dy pjesë kopshtin dhe shkonte nga vila deri në fund të pronës, ku, rrëzë murit rrethues, shiheshin tek shkëlqenin xhamat e serrave të shumta për lulet. Në gjysmë të rrugës, mes vilës dhe serrave, m'u shfaq mamaja tek ecte vetëm, nën pjergull, duke më kthyer shpinën. Për një çast vendosa të mos e thërras dhe e vështrova.

Ecte ngadalë, shumë ngadalë, si dikush që kundron përreth, kënaqet me çfarë ka përpara syve dhe që e zgjat sa më shumë të jetë e mundur soditjen. Mamaja kishte veshur një fustan të kaltër, me dy pjesë, me xhaketë të shtrënguar në bel e shumë të gjerë në shpatulla dhe fund tejet të ngushtë, pothuajse si një mill. Vishej gjithmonë kështu, me veshje shumë të ngushta, që e tregonin edhe më të hequr, të shtangët dhe të drunjte trupin e saj të imët e rakitik. Koka e saj e madhe qëndronte mbi qafën e gjatë e thatanike, flokët e verdhë kaçurrelë e pa shkëlqim, gjithmonë të valëzuar dhe të përdredhur.

Nga larg mund të dalloja qartë në qafën e saj perlat e gjerdanit, kaq të mëdha ishin. Mamaja pëlqente të stolisej me bizhuteri që binin në sy: unaza të rënda që i vërtiteshin nëpër gishtat e imët, radhë byzylykësh të stërmëdhenj të ngarkuar me hajmali dhe varëse që në çdo çast dukej sikur do t'i rrëshqisnin nga kyçet e thatë, karfica tepër të rënda për gjoksin e saj të pakët, vathë shumë të mëdhenj për veshët e saj shëmatarakë e kërcorë. Dallova, gjithashtu, edhe këtë herë, me një ndjesi të përzier mes familjaritetit dhe bezdisë, se si këpucët që mbathte në këmbë dhe çanta që shtrëngonte nën sqetull dukeshin tepër të mëdha. Kështu, si përfundim, e mblodha mendjen dhe e thirra:

- Mami.

Me mosbesimin e saj karakteristik u ndal befas, sikur dikush ta kishte prekur në shpatull, e pastaj u kthye pa i lëvizur këmbët, vetëm me trup. Pashë fytyrën e mprehtë, me faqet të hequra, me gojën e futur, me hundën e gjatë e të hollë, me sytë e qelqtë e të kaltër, që më shihnin tërthorazi. Pastaj buzëqeshi, u kthye plotësisht dhe m'u afrua, me kokën ulur, sytë ngulur në tokë, duke më thënë, gati si për detyrim:

- Mirëdita, edhe njëqind vjeç! E megjithëse qëllimi ishte dashamirës, e pata të pamundur të mos vëreja se tingulli i zërit të saj mbetej ai i zakonshmi, i thatë dhe i çjerrë, i ngjashëm më krrokatën e një sorre. Kur m'u afrua, përsëriti sërish:

- Edhe njëqind vjeç, hë de, ma puth faqen! Atëherë unë u përkula dhe i dhashë një të puthur në faqe. Ecëm krah më krah drejt fundit të rrugicës. Mamaja,

duke treguar hardhinë që mbulonte pjergulloren, tha menjëherë:

- E di çfarë po shihja? Ato vilet e rrushit tim. Shiko!

I ngrita sytë dhe pashë se vilet dukeshin të gjitha, kush më shumë e kush më pak, si të brejtura dhe të thithura.

- Hardhucat, - tha mamaja me tonin e pazakontë të afërt, të dashur e në të njëjtën kohë shkencor që kishte kur fliste për lulet dhe bimët e saj. - Ato kafshë ngjiten nëpër shtyllat e pjergullores dhe hanë rrushin. Më prishin pjergullën, sepse vilet e zeza mes hardhive të gjelbra kanë shumë pamje, por kur vilet janë gjysmë të brejtura, nuk duken aspak bukur.

Seç thashë diçka për një afresk të Zuccari-t, në një pallat në Romë, ku kishte pikturuar një pjergull të artë me vile të zeza e hardhi të gjelbra, dhe ajo vazhdoi:

- Dje, nuk e di sesi, një pulë e fshatarëve këtu afër, hyri në kopsht. Një nga këto hardhucat ishte në pjergulla duke thithur rrushin tim. Kështu, kushedi sesi, i shkoi këmba huq dhe ra në tokë. Merre me mend, as nuk e preku tokën: pula e kapi me sqep dhe e piu. Ashtu të them, e piu.

- Atëherë, duhet të mbash pula. Që të hanë hardhucat dhe kështu ato nuk do të ta hanë më rrushin, - thashë.

- Ç'është ajo fjalë? Pulat, përveçse hanë hardhucat, shkatërrojnë edhe çdo gjë tjetër, prandaj të shporren! Më mirë mbaj hardhucat.

Kështu vazhduam vizitën në kopsht, përshtuam rrugicën nën pjergull deri te muri rrethues e më pas ecëm përkrah serrave. Mamaja herë pas here përkulej të

merrte në pëllëmbë të dorës, mes dy gishtave, kurorën e ndonjë luleje të çelur gjatë natës; pastaj mahnitej, është fjala e duhur, me sy plotësisht të qelqtë, përballë vazos së baltës nga ku një bimë ujëmbajtëse e ngjashme me një gjarpër të gjelbër e leshator, kishte zbritur deri në tokë e gati të bënte çudi që nuk fishkëllente; pastaj, me ftohtësi didaskalike, më jepte kaq shumë informacione botanike, të marra nga leximi i kujdesshëm i udhëzuesve për rritjen e luleve, si dhe nga bisedat e gjata me dy kopshtarët shumë të duruar, sepse ishin shumë mirë të paguar, të cilëve u impononte shoqërinë e saj gjatë të gjithë kohës që punonin në kopsht. Siç thashë, dashuria për lulet dhe bimët ishte e vetmja anë poetike e jetës së mamasë, në të kundërt tërësisht prozaike. Ishte e vërtetë se, sipas mënyrës së saj, më donte; dhe se i kushtonte administrimit dhe shtimit të pasurisë sonë një pasion të jashtëzakonshëm. Por, si me punët ashtu edhe me mua, mbizotëronte karakteri i saj autoritar, i paskrupullt, i prirë drejt interesit dhe mosbesimit. Ndërsa lulet dhe bimët i donte pa kurrfarë interesi, me entuziazëm dhe pa qëllime të tjera. Po babanë, si e kishte dashur? Si zakonisht, m'u avit mendimi se babai dhe unë ngjanim, të paktën, në këtë drejtim: nuk donim të rrinim me mamënë. E pyeta papandehur:

- Meqë ra fjala, si ka mundësi që babai ikte vazhdimisht, larg teje?

E pashë të rrudhte hundën, siç bënte gjithmonë kur i flisja për babanë.

- Kur paska rënë fjala?

- S'ka rëndësi, përgjigju pyetjes!

- Yt atë nuk ikte nga unë, - u përgjigj pas pak me denjësi mospërfillëse, - i pëlqente të udhëtonte, ja kaq. Shiko sa të bukur trëndafilat!

- Dua të më flasësh për babanë. Po të jetë se nuk ikte nga ti, pse nuk shkoje ti me të? - thashë preraz.

- Píkësëpari, dikush duhej të qëndronte në Romë, të kujdesej për interesat tona.

- Do të thuash për interesat e tua?

- Interesat e familjes. Pastaj nuk më pëlqente si udhëtonte ai. Unë dua të udhëtoj me të gjitha kushtet. Të shkoj në vende me hotele të mira, e ku ka njerëz që njoh. Për shembull në Paris, Londër, Vjenë. Ndërsa ai do të më kishte shpënë, ku di unë, në Afganistan ose në Bolivi. Nuk e duroj dot parehatinë e nuk i duroj dot vendet ekzotike.

- Po pse ikte vazhdimisht nga shtëpia ose, siç thua ti, pse udhëtonte? Pse nuk rrinte me ty? - këmbëngula.

- Sepse nuk i pëlqente të rrinte në shtëpi.

- Po pse nuk i pëlqente të rrinte në shtëpi? Mërzitej?

- Nuk e kam vrarë ndonjëherë mendjen. Unë di që trishtohej, nuk fliste më, nuk dilte fare. Në fund ia jepja vetë paratë e i thosha: “Merri, ik, më mirë ik!”.

- Nuk mendon se po të të kishte dashur do të kishte ndenjur këtu?

- Po pra, - u përgjigj e qetë, me zërin e saj të pakëndshëm që dukej e kënaqur që thoshte të vërtetën, - por nuk më donte.

- Po pse u martua me ty atëherë?

- Doja unë të martohesha me të. Ndoshta ai nuk kishte dëshirë.



- Ishte i varfër, apo jo? Dhe ti e pasur?

- Po, ai nuk kishte asgjë. Ishte nga derë e mirë. Po asgjë më shumë se kaq.

- Ndoshta kërkonte të martohej për interes?

- Ah, jo. Nuk shihte interesin yt atë. Këtu ishte si ti. E vërtetë, kishte gjithmonë nevojë për pará, por nuk i kushtonte rëndësi parasë.

- E di pse po të pyes për babanë?

- Jo, nuk e di.

- Sepse po mendoja se, të paktën nga kjo anë, i kam ngjarë. Edhe unë largohem vazhdimisht prej teje.

E pashë të përkulej e me një gërshtë të vogël, që s'e kisha vënë re më parë, të presë me vendosmëri një lule të kuqe. Pastaj u çua dhe pyeti:

- Si po të ecën puna?

Nga kjo pyetje ndjeva befasi të më shtrëngonte diçka në fytyrë, dhe një ndjesi zyrtësie të mugët e të akullt të përhapje përreth meje, duke dalë nga unë me valë të njëpasnjëshme gjithnjë e më të mëdha, siç ndodh në natyrë kur një re qëndron mes diellit dhe tokës. Me zë mjerisht të mbytur, u përgjigja:

- Nuk pikturoj më.

- Si nuk pikturuake më?!

- Vendosa ta lë pikturën.

Mamaja s'kishte pasur ndonjëherë simpati për pikturën time, së pari, sepse nuk merrte vesh nga piktura, por nuk kishte dëshirë as ta pranonte, as ta dëgjonte nga të tjerë; së dyti, sepse, jo pa të drejtë, mendonte se kish qenë piktura që më kishte larguar prej saj. Por edhe këtë herë pata rastin të çmoj aftësinë e saj për të ruajtur

qetësinë. Një tjetër në vend të saj do të kishte shprehur sadopak kënaqësi.

- E përse ke vendosur ta lësh pikturën? - pyeti pas pak, me një kureshtje të qetë, të ngeshme e gati mondane.

Ndërkohë i ishim afruar vilës; aroma e gatimit, gatimit të mirë, ndihej në ajër. Po atë çast ndjeva se dëshpërimi im, në vend që të ulej, po rritej, ndonëse i përsërisja vetes me tërbim: “Tani do të më kalojë, tani do të më kalojë”. Dhe atëherë më erdhi në mendje një kujtim: vetja ime kur isha pesë vjeç, me njërin gju të gjakosur, ndërsa kaloja duke qarë me ngashërim, një tjetër kopsht, e vrapoja drejt mamasë që duke u përkulur mbi mua më thoshte me zërin e saj të çjerrë: “Prit, mos qaj, ma trego, mos qaj, e di ti që burrat nuk qajnë?”. E pashë mamanë dhe m’u duk, për herë të parë pas shumë kohësh, se ndieja dashuri për të. Pastaj, si përgjigje për pyetjen e saj, thashë: “Ashtu”, fjalën më të shkurtër që munda të gjej, sepse më vinte turp nga dëshpërimi im e nuk doja që ajo ta vinte re.

Por sakaq kuptova se nuk kishte kuptim të thosha “ashtu”; përgjigjja nuk e ndalte zymtësinë që më rrëqethte mishin e më kreshpëronte flokët; rreth meje, ajo dukej sikur rravonte dhe vdirrte botën e tërë. Pastaj, një fllad i lehtë ere më sollti sërish në hundë aromën e mirë të gatimit, dhe gati më lindi dëshira t’i hidhesha në krahë mamasë, i ngashëryer, si atëherë kur isha pesë vjeç, me shpresën se do të më ngushëllonte për ndërprerjen e pikturës, siç më kishte ngushëlluar atëherë për gjurin e vrarë. Thashë befas, në mënyre krejt të papritur:

- Madje, meqë ra fjala, harrova të të them se do ta lë studion që tani, nuk më hyn më në punë, dhe do të kthehem këtu me ty. Heshta një çast, i shtangur nga ato fjalë që nuk kisha ndër mend t'i thosha e që kushedi nga më buronin. Pastaj, kur e kuptova që nuk tërhiqesha dot, shtova mundimshëm: - Gjithmonë nëse më pranon.

Pavarësisht habitës në të cilën më kishte shtënë vetë propozimi im, pata rastin të çmoj për herë të dytë aftësinë e mamasë për të fshehur ndjenjat: atë aftësi që në gjuhën e saj mondane ajo e quante “forma”. I kisha thënë atë që priste prej vitesh; të vetmen gjë, ndoshta, që mund ta kënaqte; gjithsesi, kurrgjë nuk ndryshoi në fytyrën e saj të thatë e të ashpër, në sytë e saj të qelqtë. Ngadalë, me zë veçanërisht të pakëndshëm, me tonin e dikujt që në një pritje kthen një kompliment për të cilin s’ka kurrfarë interesi, tha:

- Si nuk të dashkam. Në këtë shtëpi do të të pres gjithmonë krahëhapur. Kur kishe ndër mend të vije?

- Sonte ose nesër në mëngjes.

- Më mirë nesër në mëngjes, që të kemi kohë për të të rregulluar dhomën.

- Atëherë, nesër në mëngjes.

Pas këtyre fjalëve nuk thamë asgjë tjetër për pak kohë. Unë vramendesha për sjelljen time; mos vallë prirja ime ishte të qëndroja në shtëpi me mamanë, të pranoja mërzinë dhe administrimin e pasurisë sonë dhe të isha i pasur? Mamaja, nga ana e saj, dukej sikur e kishte kaluar fazën e çmeritjes dhe vetëkënaqësisë për fitoren e pashpresuar; e sakaq mendonte, siç mund të shquhej nga shprehja përsiatëse e fytyrës së saj të vrazhdë e të

palëvizshme, për organizimin e fitores, domethënë për planet mbi të ardhmen time dhe të sajën. Në fund shtoi me ton të dosidoshëm:

- Nuk e di në e ke bërë me qëllim, por, gjithsesi, është ogur i mirë. Sot është festa jote dhe sot vendose të kthehesh në shtëpi. Të thashë në mëngjes që të kam përgatitur një surprizë. Do të vlejë për të dyja sebepe.

- Çfarë surprize? - bëra një pyetje të rastësishme.

- Eja me mua të ta tregoj!

- Sido që të jetë, sot festojmë vetëm një sebeb: kthimin tim në shtëpi. Kjo është festa e vërtetë për sot, - thashë mizorisht.

E dalloi mamaja sarkazmin tim? Apo nuk e vuri re? E sigurt është që nuk tha asgjë. Ndërkohë ecte përpara meje përreth murit të vilës, drejt sheshpushimit. E pashë t'i avitej me vendosmëri makinës së bukur sportive që ndodhej pranë simes e më pas të ndalonte me një rën dorë mbi kofano, pak a shumë siç qëndrojnë vajzat e fotografuara në fabrikat e makinave:

- Një herë ke shprehur dëshirën për të pasur një makinë shumë të shpejtë. Në fillim mendova të të blija një makinë garash, por ato janë të rrezikshme, kështu zgjodha një makinë me tavan të lëvizshëm. Shitësi më tha që ky është modeli i fundit, ka dalë nga fabrika pak muaj më parë. Ecën me dyqind në orë.

U afrova ngadalë, duke menduar sa mund të kushtonte makina që mamaja më kishte dhuruar: tre milionë, katër? Ishte markë e huaj, me karroceri luksoze: e dija se këto makina kushtonin shumë. Tani, mamaja fliste për makinën me të njëjtin ton shkencor, të largët,

kërshërues e gati të përzemërt, që përdorte në ligjëratat për lulet e kopshtit të saj:

- Kjo më pëlqen në veçanti, - tha, duke treguar kroskotin e zi, ku sustat dhe levat e nikeluara shkëlqenin si diamante mbi mëndafshet e zeza të një argjendari, - do ta kisha blerë vetëm për këtë. Pastaj më pëlqen sepse është e thukët si një palë këpucë të forta, të bëra me dorë e të prodhuara bash për ecje të gjata. Një fortësi që të jep siguri. Do ta provosh? Kemi kohë ta bëjmë një xhiro përpara dreke, por vetëm pak minuta, sepse kemi një gjellë që nuk mund të presë dhe kuzhinierja ka merak që t'i ta pëlqesh, e ka bërë enkas për ty.

- Si të duash, - murmurita duke parë me hutim makinën.

- Provoje, sepse duhet ta konfirmoj blerjen.

Nuk thashë asgjë, hapa derën e makinës dhe hipa. Mamaja u ul përkrah meje dhe, ndërsa ndizja motorin dhe ulja marshin, më informoi me tonin e zakonshëm të afërt dhe shkencor:

- Është me tavan të lëvizshëm. Shitësi më garantoj se në dimër nuk hyn as edhe një fije ere. Pastaj ka edhe ngrohje. Në verë mund ta hapësh tavanin, ka më shumë ëndje të ecësh ashtu.

- Po, ka më shumë ëndje.

- Të pëlqen ngjyra? Mua m'u duk shumë e bukur, nuk kërkova tjetër pasi e pashë. Shitësi më tha se ngjyra metalike realizohet me një proces shumë të kushtueshëm, por ka pamje më elegante.

- Është shumë më e hijshme, - thashë rastësisht.

- Kur të zbërdhulet mund ta lyesh papë.

Makina lëshoi një uturimë shumë të fortë, bash si motorët e makinave të garave, pastaj e rrotullova në sheshpushim dhe mora rrugicën e hyrjes. Ishte makinë shumë e fuqishme dhe shumë e ëmbël njëkohësisht, më rrëshqiste nën këmbë edhe me shtypjen më të lehtë të pedalit të gazit. Kaluam derën dhe s'munda të mos e kujtoj ndjesinë e mëparshme kur, duke ardhur drejt vilës, më ishte dukur sikur po futesha në barkun që më kishte lindur. Po tani? Tani isha brenda këtij barku e nuk do të dilja më kurrë.

Sapo e kaluam derën, mora djathtas dhe iu ngjita rrugës “Appia” në drejtim të kështjellave. Dita e shpëlarë dhe e lagësht kishte mbledhur në malin Cavo një si unazë të zezë, të rravguar e të pasigurt, me re deri diku të stuhishme; përgjatë rrugës “Appia” me pisha, qiparisa, gërmadha, gardhe, fusha, gjithçka dukej e paqartë dhe e mugët prej pluhurit dhe e regjur nga vera. Mamaja vazhdonte të lëvdonte makinën, në mënyrë të rastësishme dhe mondane, sikur t'ia zbulonte rrugës gjithë cilësitë. Përshkova deri në fund rrugën “Appia” pa hapur gojë, pastaj mora majtas, me shpejtësi të lartë zbrita deri tek “Appia e Re”, i rashë përqark semaforit dhe u ktheva prapa.

- Si të duket? - pyeti mamaja kur morëm sërish rrugën “Appia e Lashtë”.

- Më duket makinë e shkëlqyer nga çdo anë. E njoh mirë këtë makinë.

- Po ky është model i ri, s'ka një muaj që ka dalë.

- Dua të them: i njoh makinat e kësaj marke.

Ja dera, ja rruga me qiparisa, ja vila në anën tjetër të sheshpushimit. Bëra një gjysmërrrotullim, ndalova,

ngrita frenat e dorës, pastaj, pasi qëndrova një çast në heshtje e pa lëvizur, u ktheva vrik nga mamaja duke i thënë:

- Faleminderit.

- E bleva, mbi të gjitha, - u përgjigj, - sepse më pëlqente shumë. Po të mos e kisha blerë për ty, do ta kisha blerë për vete.

Veçse m'u duk sikur priste ende diçka, të paktën nga pamja e saj e pakënaqur dhe kërkuese.

- Më pëlqen vërtet shumë, - thashë sërish, - faleminderit. Dhe duke u avitur ceka me buzë grimin e thatë e të ashpër në faqen e saj të dobët. Ajo, ndoshta për të fshehur vetëkënaqësinë që i zgjoi gjesti im i dashur, tha:

- Shitësi më këshilloi që, përpara përdorimit, të lexohen mirë udhëzimet për drejtimin dhe mirëmbajtjen në këtë manualin këtu, - hapi një sirtar të vogël në kroskot dhe më tregoi një doracak të verdhemë, - sepse janë makina delikate dhe prishen shumë kollaj.

- Do ta lexoj.

- Është makinë edhe për udhëtime të gjata. Për shembull, në vjeshtë mund të shkosh në Spanjë, ose në Francë.

- Do të shkoj në pranverë, në vjeshtë nuk kam mundësi.

- Po, patjetër, edhe në pranverë. Vendi i bagazhit është i madh, nxë tri valixhe.

Tani mamaja më dukej vërtet e kënaqur; kaq shumë, sa një pjesë e "formës" ishte lëkundur dhe mund të përshquhej qartë, si rrallëherë, se ishte e kënaqur.

Përshkuam sheshpushimin, mamaja më tregoi në të majtë një rrugicë të drejtë, të ngushtë e të gjatë, me dafina anash, ku në fund dallohej një ndërtesë e vogël me ngjyrë të kuqe, njëkatëshe, dhe tha:

- Studioja jote. Ka mbetur ashtu siç e ke lënë. Asgjë s'ka ndryshuar. Po të duash, mund të shkosh të pikturosh që nesër.

- Të thashë që kam vendosur të mos pikturoj më.

Nuk u përgjigj, ndoshta ma kish përmendur studion vetëm që ta dëgjonte edhe një herë që kisha hequr dorë nga piktura. Ndërkohë kishim mbërritur te dera e shtëpisë. Mamaja eci përpara meje në mesore, duke thënë me ton autoritar:

- Tani shko të lash duart, sepse dreka është gati. Hapi një derë që nxirrte, siç e dija, në një korridor që të çonte në kuzhinë, dhe u zhduk. Unë shkova në gardërobë përmes një dera tjetër. Ndër katër muret e kaltra të banjës, pashë veten mekanikisht në pasqyrën mbi lavaman, ndërsa duart e mia mbështilleshin në shkumën e sapunit, nën çurgun e ngrohtë të ujit. Bash në atë çast, pas meje, dera u çel e në pasqyrë pashë, mes pragut dhe shtalkës, kokën me flokë tepër të shkurtër e të prerë keq të kamerieres që pak më parë më kishte pritur te dera.

Pyeta pa u kthyer, duke e parë në pasqyrë:

- Si quheni ju?

- Rita.

- Nuk ju kisha parë herë tjetër.

- Një javë kam që punoj këtu.

U përkula dhe sapunisa me vrull fytyrën, paçka se nuk e kisha të nevojshme: më dukej se isha fëlliqur nga



mendimet mbyttëse. Ndërsa lahesha, dëgjova zërin e ëmbël të Ritës që njoftonte:

- Peshqirin e kam vënë këtu, - dhe shkunda kokën për të thënë se ishte mirë. Kur ngrita kokën, vura re se vajza ishte larguar. Dola nga banja dhe, përmes paradhomës, shkova drejt sallonit, ose më saktë drejt katër a pesë salloneve, dhomave të pritjes e të ndenjjes që zinin katin përdhes të vilës.

Dhomat e pritjes dhe ndenjjes, që komunikonin me njëra-tjetrën me harqe ose dyer pa kanate, duke krijuar kështu një ambient të vetëm, ishin mobiluar në një mënyrë aspak personale, me mobilie të mërzitshme, të rënda e pa karakter, të zgjedhura vetëm për vlerën e tyre monetare. Kuptohej fare lehtë se atje brenda nuk kishte as edhe një send që të mos ishte më i kushtueshmi, ose të paktën, ndër më të kushtueshmit e kategorisë së cilës i përkiste. Mamaja nuk kishte as shije, as kulturë, as kureshtje, as dashuri për të bukurën; kriteri i saj përzgjedhës për çdo blerje ishte gjithmonë çmimi, që sa më i lartë të ishte, aq më shumë e bindte se sendi në shitje kishte cilësi bukurie, elegance dhe origjinaliteti; ndryshe ajo nuk do të kishte qenë në gjendje t'i përshquante. Natyrisht, mamaja nuk i hidhte paratë nga dritarja, përkundrazi, bënte kujdes të madh, dhe jo pak herë e kisha dëgjuar të thoshte në dyqan: “Jo, shumë shtrenjtë, nuk bëhet fjalë”, por unë e dija se kjo thirrje kishte të bënte me mundësitë e saj financiare e jo me vlerën reale të sendit, për të cilin ajo nuk kishte kurrfarë dijenie, por, duke qenë i paarritshëm për kuletën e saj, mbetej gjithsesi i dëshirueshëm, bash sepse ishte i shtrenjtë.

Rezultati i këtij kriteri përzgjedhës, ishte, siç thashë, një koleksion mobiliesh pa karakter e pa intimitet, por të thukëta e hijerënda, sepse mamaja, përtej vlerës monetare, i kushtonte shumë rëndësi edhe përmasave dhe vëllimit, si dy cilësi të tjera që ajo ishte në gjendje t'i gjykonte dhe kuptonte. Kështu, divanet e thella, kolltukët e stërmëdhenj, abazhurët gjigantë, tavolinat masive, perdet e rënda, zbukurimet monumentale, çdo gjë në ato dhoma ngjallte idenë e një luksi të konsiderueshëm e cilësor. Kudo, në gjysmëhije, shkëlqenin pasqyrimet e dyshemeve të fërkuara me dyllë, të sipërfaqeve prej druri pa asnjë grimë pluhuri, të orendive të bronzta e të argjendta të lustruara: pastërtia ishte një tjetër veçori e shtëpisë. Së fundmi, si zakonisht, vura re të shpërndara ngado, vazo të mbushura me tufa lulësh disi të përmortshme që, siç e dija, mamaja dilte t'i mblidhte në serrë çdo ditë në agim. Vura re se po i vështroja të gjitha këto me sy tjetër, jo më aq i pavëmendshëm e mospërfillës, si për të rrokur ndjesinë që më jepnin tani që kisha vendosur të kthehesha në shtëpinë e mamasë. Dhe zbulova se ndieja një vetëkënaqësi të turpshme e të krupshme, si përballë një tundimi të vjetër, tashmë ngadhënjimtar, por gjithmonë të neveritshëm. U afrova te pasqyra antike me kornizën e rëndë që sundonte mbi një tavolinë në fund të sallonit, pashë veten dhe papritur ndjeva nevojën të shaja veten me zë të lartë, pa e ditur në e kisha me urrejtje a me gëzim: “Idiot”. Gati në të njëjtin çast dëgjova një fëshfërimë.

Ktheva kokën dhe pashë kameriere Ritën që, pak hapa prapa meje, në këmbë pranë bufesë së lëvizshme

me rrota, më shikonte me sy hetues, përmes xhamave të trashë të gjyzykëve me skelet të zi. Mendova se më kishte parë ndërsa shaja veten, pashë fytyrën e saj të zbehtë dhe dinake e nuk munda të kuptoj kurrëgjë. Ajo, pas një çasti heshtjeje tha:

- Zonja do të zbresë sakaq. Më tha t'ju përgatis një pije. Çfarë dëshironi?

Sërisht mendova a kishte në zërin e saj ironinë që fytyra nuk ia shpërfaqte. Por jo, ishte zë serioz, ose të paktën, serioz deri në hipokrizi. I thashë që dëshiroja një uiski dhe ajo, me shumë kujdes, mori shishen e uiskit, shtiu pak në një gotë, shtoi një copë akulli dhe pak ujë dhe ma zgjati duke më pyetur:

- Dëshironi gjë tjetër?

U përgjigja se nuk doja gjë tjetër; dhe e pashë të largohej pa zhurmë, me këpucët e saj me shollë plisi. U ula në njërin prej kolltukëve të gjerë, me gotën e uiskit, ndeza një cigare dhe nisa të mendohem. Pse e kisha sharë veten ashtu përpara pasqyrës? Me sa duket, mendova në fund, rreziku i kësaj komedisë së djalit plëngprishës që po recitoja me veten, ishte t'u dorëzohesha, bash atëherë kur nuk e prisja e kur nuk e dëshiroja, disa tundimeve të papritura përdhosëse e të palejueshme. Me fjalë të tjera, isha një djalë plëngprishës i një lloji të veçantë, i cili, në çastin që priste përçafimin e prindit plak, ndiente tundimin t'i fuste këtij të fundit një shkelm të mirë në kërci, e që, pasi ka konsumuar gostinë e hareshme, shkon ta vjellë në kopsht. Nuk pata kohë të përsiatem në këto mendime interesante, pasi mamaja hyri papritur:

- Të dha për të pirë Rita?

- Po, faleminderit, po kush është kjo Rita?

- Është një e re, kishte rekomandime të shkëlqyera, punonte për ca amerikanë që u larguan. Në të vërtetë ishte si dado, po këtu s'kemi fëmijë, kështu që i thashë: "Vajzë e dashur, jam e detyruar t'ju ul në pozitë me detyrën e kamerieres. Jeni e lirë të pranoni ose jo". Ajo, natyrisht, pranoi, ta pret mendja, me tërë këtë papunësi që kemi...

Mamaja vazhdoi të fliste për Ritën edhe pasi hyri në dhomën e ngrënies, ku vetë Rita qëndronte në këmbë krah tavolinës, me doreza plastike në duar, skufje dantelle në flokë dhe me përparësen ovale në brez. Do të kisha dashur t'i thosha mamasë: "Kujdes, po flet për Ritën, dhe Rita është këtu", pastaj vështrova fytyrën dinake e me gjyzlykë të vajzës dhe krejt papritur pata sigurinë se më kishte parë ndërsa shihesha në pasqyrë e i thosha vetes idiot. M'u duk sikur kjo mundësi, në fund të fundit, nuk më shqetësonte, sikur, që nga ai çast, mes meje dhe Ritës ishte vendosur një lloj bashkëfajësie. U ula dhe mamaja gjithashtu duke u ulur tha:

- Rita, zoti Dino është im bir dhe nesër në mëngjes do të vijë të jetojë këtu. Mos e harroni: po të kërkojnë në telefon një zotëri me emrin Dino, ky Dinoja është im bir.

Tani qëndronim ulur kundrejt njëri-tjetrit, në një tavolinë të vogël të rrumbullakët, në një dhomë jo të madhe, por me tavan shumë të lartë, me duar mbi sofrabezin me dantellë fiorentine, përballë pjatave me porcelan gjerman, me takëmet e argjendta angleze e gotat e kristalta franceze në krah. Pas karriges së

mamasë shkëlqenin në hije gdhendjet e praruara të një bufeje holandeze; pas meje mbaja mend se kishte një bufe veneciane. Dera që të nxirrte në kopsht ishte e hapur, por perdet ishin të bashkuara, sepse mamaja nuk dëshironte, kështu thoshte, që ndonjë kopshtar t'i numëronte kafshatat kur hante. Mamaja ma shtiu vetë verën nga një brokë prej kristali dhe argjendi, e më pas i tha Ritës të shërbente. Vajza mori nga bufeja një tavë porcelani të vendosur mbi një tabaka dhe iu afrua mamasë, e cila foli thatë:

- Shërbeni më parë zotin Dino.

- Pse? Ti e para.

- Jo, unë...

- Rita, shërbeni më parë zonjën.

- Unë nuk ha pothuajse fare, - tha mamaja, - dhe me majën e lugës vuri diçka në pjatë. Rita m'u afrua dhe atëherë kuptova ç'ishte ajo aromë e mirë që kisha nuhatur në kopsht: pastiço me makarona.

- E dija që të pëlqen, - tha mamaja, - dhe u thashë ta bënin enkas për ty.

- E mirë, e mirë, e mirë, - thashë me vetëkënaqësi mazokiste dhe mora në pjatë një racion të stërmadh. Tani, unë zakonisht haja pak, e sidomos nuk haja të tilla ushqime. Nuk munda të mos mendoj se po vazhdoja kështu komedinë e djalit plëngprishës. Kur papritur ia plasa së qeshurës. Mamaja pyeti e shqetësuar:

- Pse qesh?

- M'u kujtua se kam lexuar diku një parodi të lezetshme të parabolës së djalit plëngprishës, e ke parasysh në Ungjill? - u përgjigja.

- Si është?

- Në tregimin alegorik , djali plëngprishës kthehet në shtëpi, babai e pret me të gjitha nderimet dhe ther për të viçin e majmur. Ndërsa në parodi, viçi i majmur ia mbath i trembur sapo kthehet djali plëngprishës, duke e ditur mirë se çfarë e priste. Atëherë e presin. Viçi i majmur i lë të presin gjatë e mandej vendos të kthehet. Në rrezgun e gëzimit, babai, për të kremtuar kthimin e viçit të majmur, vret djalin plëngprishës dhe ia jep ta hajë.

Mamaja, siç e dija, nuk kishte besim në asgjësend, veç parasë. Por besonte, gjithsesi, siç edhe thashë, në atë që quante “formë”; e cila, ndër të tjera, të shtrëngonte të ishte “praktikues” dhe, gjithsesi, të respektoje gjërat e fesë. E pashë të ashpërsohej në fytyrë; më pas tha me zërin e saj më të papëlqyeshëm:

- E di që nuk më pëlqen kur tallesh me gjëra të shenjta.

- Aspak, unë nuk tallem. Çfarë do të thotë kthimi im, pra, veç sakrifkimit të djalit plëngprishës, që jam unë, në të mirë të viçit të majmë që është e gjitha kjo? Dhe bëra një gjest qerthullor për të treguar mobilet luksoze të dhomës.

- Nuk të kuptoj.

Mamaja, me të sajën, kishte një humor të çuditshëm, disi të zymtë dhe të vetvetishëm; kështu shtoi pa buzëqeshur: “Gjithsesi, veç pastiços kemi edhe mish viçi, s’e di a ishte i majmur apo jo”.

Nuk thashë asgjë dhe nisa të përlej racionin tim të pastiços me një ndjesi të përzier mes gëzimit dhe pendesës, sepse kisha me të vërtetë uri dhe pastiçoja

ishte e mirë e në të njëjtën kohë ndieja zemërim ngase e pëlqeja. Më pas ngrita sytë nga mamaja dhe pashë që më shikonte me mosmiratim.

- Duhet të përtypësh ushqimin më shumë, - tha. -  
Tretja e parë bëhet në gojë.

- Shumë e shpifur. Kush e ka thënë?

- E thonë të gjithë doktorët.

Sytë e saj të kaltër, të qelqtë dhe pa shprehje më ruanin në mënyrë të papërcaktueshme, që sipër duarve të kryqëzuara dhe të ngarkuara me unaza mbi të cilat kishte mbështetur mjekrën. E boshatisa me nxitim pjatën time; mamaja, me zërin e saj të ftohtë e të çakorduar, tha:

- Shërbejeni sërish zotin Dino, - dhe Rita që, ndërkohë, kishte ndenjur e mbështetur në bufenë pas mamasë, mori edhe një herë tavën dhe u afrua. Mora pirunin me njërën dorë, duke e lënë tjetrën atje ku ishte, në cep të tavolinës. Atëherë ndjeva se dora me të cilën Rita mbante tavën po prekte timen, në një mënyrë që mund të kish qenë edhe e qëllimshme. Nuk i kushtova dhe aq rëndësi këtij supozimi dhe vazhdova të ha. Pyeta në fund me ton të pakujdesshëm:

- Po ti, me se merresh zakonisht?

- Ç'do të thuash?

- Dua të them pikërisht atë që thashë: çfarë bën zakonisht?

- Oh, atë që kam bërë gjithmonë, ti e di.

- Po, por në gjithë këto vite që s'kam jetuar këtu nuk të kam pyetur kurrë se me çfarë merresh. Tani, ndoshta sepse po kthehem këtu, kam kureshtje ta di. Kushedi, ndoshta çdo gjë është ndryshe.

- Mua s'më pëlqen të ndryshoj asgjë. Më pëlqen të mendoj se jetoj tani ashtu siç jetoja dhjetë vjet më parë, e siç do të jetoj pas dhjetë vjetësh.

- Po prapë unë nuk e di sesi jeton; atëherë, në ç'orë zgjohesh në mëngjes?

- Në tetë.

- Kaq shpejt? Shpesh, kur kam marrë në telefon në nëntë, më kanë thënë: "Zonja po pushon".

- Po, ka raste që fle më shumë, sepse fle vonë.

- Po kur zgjohesh çfarë bën? Ha mëngjes?

- Kuptohet.

- Në dhomën tënde apo në dhomën e ngrënies?

- Në dhomën time.

- Në krevat apo në tavolinë?

- Në tavolinë.

- Çfarë ha në mëngjes?

- Çaj, bukë të thekur, si gjithmonë, dhe një lëng portokalli.

- Po pas mëngjesit çfarë bën?

- Bëj banjë. Mamaja u përgjigjej pyetjeve të mia me ton të mërishëm, njëkohësisht dinjitoz dhe të habitur, sikur unë të kisha vënë në dyshim nëse në të vërtetë ajo hante mëngjes apo lahej.

- Bën banjë apo dush?

- Banjë.

- Lahesh vetë apo të ndihmon kamerierja?

- Kamerierja kujdeset për temperaturën e ujit, hedh kripërat, dhe kur banja është gati, më ndihmon të laj ato pjesë të trupit që unë nuk i arrij dot.

- Po pastaj?



- Pastaj dal nga uji, thaj trupin dhe vishem.  
- Kamerierja të ndihmon edhe që të vishesh?  
- Më ndihmon të vesh çorapet. Rrobat jo, më pëlqen të vishem vetë.

- Flet me kamerieren, ndërkohë që bën banjë dhe vishesh?

Papritur mamaja filloi të qeshë, gati pa ëndje, me njëfarë nervozizmi:

- E di që je i çuditshëm me këto pyetjet e tua? Ndoshta nuk kam dëshirë të të kthej përgjigje. Jeta ime private më takon vetëm mua.

- Nuk të pyeta për atë që mendon, por për atë që bën. Mundohu të më kuptosh. Unë kthehem në shtëpi pas dhjetë vjetësh. Kam të drejtë të mësohem me jetën këtu. Atëherë, flet me kamerieren?

- Ta pret mendja, i flas, nuk është robot, është njeri.

- Kur i vë bizhuteritë, përpara apo pasi vishesh?

- I vë në fund.

- Çfarë rendi ndjek, domethënë çfarë vë në fillim e çfarë më pas?

- E di çfarë më kujton? Hetuesit e librave policorë, kur kanë ndonjë krim për të zbuluar.

- Edhe unë duhet të zbuloj diçka.

- Çfarë?

- Nuk e di, diçka. Atëherë, në ç'rend i vë bizhuteritë?

- Në fillim unazat dhe byzylykët, pastaj varësen e pastaj vathët. U kënaqë?

- Pasi vishesh çfarë bën?

- Ulem poshtë dhe shkoj t'i jap urdhrat kuzhinieres, për gjithë ditën.

- Domethënë shkruan një listë për drekën dhe darkën?

- Ashtu.

- Po pastaj?

- Shkoj në kopsht, mbledh lule, i çoj në shtëpi dhe i vë nëpër vazo. Ose shëtis dhe flas me kopshtarët. Me një fjalë, kujdesem për kopshtin.

- Pas kopshtit çfarë bën?

E pashë të më vështronte një çast, dhe pastaj të përgjigjej thujse solemnisht:

- Shkoj në studio dhe kujdesem për administrimin.

- Çdo ditë?

- Po, çdo ditë, ka gjithmonë diçka për të bërë.

- E çfarë bën?

- E po shkruaj, ose pres njerëz.

- Domethënë, vijnë të të takojnë avokatë, financierë, agjentë burse, njerëz të besuar e gjëra të këtij lloji?

Papritur nisi të qeshë sërish, por këtë herë e vetëkënaqur dhe gati sensuale, që tregonte se kisha kapur një pikë të dobët:

- Të duket punë e lehtë kjo që bëj unë? Mund të mos jetë si piktura, dakord, por prapëseprapë është një punë rraskapitëse që më angazhon gjithë paraditen e ndonjëherë edhe pasdite.

- E po, më mirë të jesh e angazhuar, apo jo?

- Ka ditë që më kap edhe një dhimbje e vazhdueshme këtu, në qafë.

- Duhet ta kursesh veten.

Mamaja e peshoi një çast atë që thashë, ndoshta me dashamirësi, pastaj foli me zërin e saj të çjerrë:

- E bëj për ty, që pasuria jote të ruhet e të shtohet.  
- Pasuria ime? Jo, jotja.  
- Kur të vdes do të bëhet jotja.  
- Je akoma shumë e re, me siguri do të vdes unë më parë. Nga mërzia. Gjithsesi, le të themi: pasuria jonë. Si i kemi punët, atëherë, me pasurinë tonë? Si i kemi punët?

- E di që je vërtet i çuditshëm. Mirë i kemi punët, falë mundimit tim. Ta dish se po të mos kish qenë për mua, tani s'do të kishim as edhe një kacidhe.

- Qenkemi, pra, shumë të pasur, apo jo?

Mamaja nuk iu përgjigj kësaj pyetjeje, por më vështroi me fytyrën e ashpër dhe sytë e qelqtë. Pastaj tha:

- Rita, ç'më rrini atje si hu gardhi? Shikoni, a është gati pjata e dytë? Pashë Ritën të përmendej si të ishte në zhgjiëndërr e të dilte. Menjëherë mamaja shtoi:

- Të lutem, sa herë të kam thënë të mos flasësh për pará në sy të shërbyesve.

- Pse kështu? Se mos thashë ndonjë gjë të turpshme. Për pará fola. Mos janë të turpshme paratë?

Mamaja shkundi kokën, me sytë ulur, sikur të largonte, pa e shqyrtuar, argumentin tim. Pastaj tha:

- Ata janë të varfër, s'është e drejtë t'i shpërfaqësh pasurinë të varfrit.

- Por ti nuk do që të flasim për pasurinë as kur jemi vetëm. Prishesh në fytyrë, duket sikur skandalizohesh, gati sikur po flasim për gjëra seksuale e jo për pará.

Tjetër shkundje koke.

- Sipas vendit bëhet kuvendi, prandaj, meqë po kthehesh këtu, është e nevojshme të flasim. Pas dreke

do të shkojmë në studio e do të të jap informacionin që kërkon.

Në atë çast u kthye Rita me një pjatancë ovale, në të cilën, mes grumbujve të perimeve të stinës, ishte vendosur, i prerë në shumë feta, viçi i paralajmëruar nga mamaja. Thashë thjesht, i nxitur nga kushedi ç'demon idhnak:

- Ama, nuk iu përgjigje pyetjes sime: jemi apo nuk jemi të pasur?

Këtë herë nuk u mjaftua me një përgjigje të heshtur: nën tavolinë ndjeva papritur këmbën e saj që kërkonte e shtypte dhunshëm timen. Pastaj i tha Ritës:

- Shërbeni zotin Dino, unë s'e ha mishin.

Këmba e mamasë mbi timen më ngjalli një ndjesi dëshpërimi. Ajo më shtypte këmbën siç bëjnë të dashuruarit mes tyre; vetëm se ne ishim nënë e bir dhe lidhja që na bashkonte nuk ishte dashuria, por paraja. Nga ana tjetër, unë nuk mund ta refuzoja këtë lidhje, sepse kështu refuzoja edhe lidhjen e gjakut që nënkuptonte. Pra, s'kisha ç'të bëja: me hir a me pahir, unë isha i pasur; ta refuzoja pasurinë ishte njëlloj sikur ta pranoja.

Dëshpërimi im, gjithsesi, mori një drejtim të papritur. Rita më zgjaste pjatën me mishin e viçit, duke përkulur në drejtimin tim gjoksin e thukët dhe fytyrën pikaloshë e dinake, me gojën e bukur e të zbehtë ngjyrë rozë: dhe unë, atëherë, i fshehur nga tabakaja, ngrita dorën që mbaja mbi tavolinë dhe e kapa nga kyçi, duke u ngjitur më pas deri te krahu. Më shërbeu me dorën tjetër, e mandej, pasi e lashë pirunin në tabaka, këmbëngula sërish, me gjakftohtësi:

- Atëherë, jemi të pasur, apo jo? Për herë të dytë ndjeva këmbën e mamasë që përpushte timen. Pastaj thashë: - Prit, Rita!

E bindur, Rita u kthye e më zgjati për herë të dytë tabakanë. Mora prapë me njëren dorë pirunin dhe nisa të mbledh nëpër pjatë copa mishi dhe perimesh. Ndërkohë, me dorën tjetër që kisha lëshuar të varej në krah të karriges, prekja këmbën e Ritës, lart, deri te vithet. Ndjeva, nën dorë, përmes fustanit të trashë, muskujt e këmbës të dridheshin, si ata të kuajve kur i përkëdhel i zoti. Por kurrfarë shprehie nuk mori në fytyrën që tani jo vetëm dukej hipokrite, por ishte pa dyshim e tillë. Në fund u largua; dhe unë, duke kapur, të paktën kështu m'u duk, gati një shikim të shpejtë mirëkuptimi pas syzeve të saj, s'kisha si të mos mendoja se që tani, pa u kthyer ende në shtëpinë e mamasë, gjendesha në një situatë më të rëndë nga ajo që ishte dhjetë vjet më parë: atëherë, edhe po të kisha pasur arsye, nuk do ta kisha prekur kurrë me dorë një kameriere. Ndërkohë mamaja e kishte hequr këmbën nga këpuca ime bash në çastin që unë kisha hequr dorën nga ijët e Ritës, me një njëkohësi të habitshme, sikur të kishte vepruar në një mendje me mua. Duke iu rikthyer bisedës së ndërprerë, thashë:

- Pra, ti punon edhe pas orës një, çdo ditë?
- Çdo ditë, përveç të dielave.
- Të dielave çfarë bën?
- Shkoj në meshë.
- Në cilën kishë?
- Te Shën Sebastiani.

- Çfarë bën në kishë?
- Bëj atë që bëjnë të gjithë, dëgjoj meshën.
- Rrëfeshesh ndonjëherë?
- Ta pret mendja që rrëfeshem. Madje marr edhe kungatën.
- Po prifti, të fal kur rrëfeshesh?
- Nuk kam mëkate të mëdha për të rrëfyer, - tha mamaja si me spitullim.
- E di si më thotë don Luixhi ndonjëherë: “Zonjë, ju e mbyllni atje ku të tjerët sapo kanë filluar”. Ç’mëkate mendon se mund të bëj unë në këtë moshë? Dhe më vështroi si për të thënë: “Kam hequr dorë prej kohësh nga e vetmja gjë që mund të më shpjerë në tundim”.
- Heshta një çast, pastaj vazhdova:
- Kthehemi sërish te dita jote: në ditë pune, pra, ti punon paradite. Po pastaj çfarë bën?
- Ha drekë.
- Vetëm?
- Po, drekën e ha gjithmonë vetëm. Ndonjëherë, veç në të rrallë, e mbaj për drekë avokatin; ama, vetëm kur s’kemi mbaruar dhe duhet të vazhdojmë pasdite.
- Cilin avokat? De Santisin?
- Po, e kam akoma avokat.
- Po pas drekës?
- Pas drekës, bëj një shëtitje në kopsht.
- Po pastaj?
- Pastaj pushoj.
- Domethënë, fle?
- Jo, nuk fle, heq këpucët dhe shtrihem në krevat pa u zhveshur. Por nuk fle, harrohem në mendimet e mia.

- Çfarë mendon?

Sërish e pashë të qeshte në mënyrë nervoze dhe të druajtur, si një vajzë që tundohet të flasë për dashurinë e saj.

- Varet. E di çfarë mendoj këto ditë?

- Jo, çfarë mendon?

- Mendoj për një ndërtesë që shitet në “Lungotevere Flaminio”. Ka leverdi, por është problem zona. Fatkeqësisht, tani nuk mund ta përballoj, por prapë e mendoj. Herë tjetër mendoj për shpenzime që mund t’i përballoj, si kjo për shembull, - zgjati dorën e më tregoi një unazë me një smerald të madh të rrethuar me diamante. E mendova gjatë, duke peshuar mirë të mirat e të këqijat dhe në fund mblodha mendjen dhe e bleva.

- Po pas pushimit, çfarë bën?

- Po mirë, ç’janë gjithë këto pyetje?

- Ta thashë, që të ambientohem prapë.

- Bëj shumë gjëra, për shembull vizita, - tha pa dëshirë.

- Ku shkon?

- Varet, në ndonjë pritje, ndonjë festë, pastaj kam disa shoqe.

- Ke shumë shoqe?

- Kam ruajtur të gjitha miqësitë që kisha kur isha në kolegji, - tha mamaja papritur me shprehje të mendueshme, - më vonë, kushedi pse, nuk kam lidhur miqësi me asnjë.

- Çfarë bën me shoqet?

- Si ta merr mendja ty? Bëjmë atë që bëjnë gratë kur rrinë bashkë. Bisedojmë, pimë çaj ose *Martini*, luajmë.

- Ç'lojë luani?
- Sa i mërzitshëm je! Luajmë brixh, ose kanastë, ose poker. Ndonjëherë, mbrëmjeve, organizoj kampionate brixhi ose kanaste.
- Ah, po, më kujtohet, kampionatet për bamirësi, apo jo? Kë ndihmoni?
- Herën e fundit ndihmuam të verbrit e luftës.
- Të verbrit e luftës. Jemi të gjithë, deri diku, të verbër luftime, apo jo?
- Tani nuk po të kuptoj. Në qoftë shaka, më duket fare pa kripë.
- S'ka rëndësi. Po te rrobaqepëset, shkon?
- Duke qenë se nuk dal lakuriq, duhet të shkoj edhe atje. Bëre mirë që ma kujtove, se do ta kisha harruar: nesër është sfilata e Fantit.
- Ah, akoma kjo Fanti. S'paska vdekur akoma?
- E shkreta, pse do që të vdesë? Jo vetëm që s'ka vdekur, por të mban mend mirë, kur ishe i vogël e më shoqëroje mua. Më pyet gjithmonë çfarë bën, si je, uron të martohesh e t'ia çosh edhe tët shoqe.
- Po mbrëmjeve çfarë bën?
- Ha darkë, shpeshherë kam mysafirë. Ndonjëherë shtroj darka, me gjashtë a tetë vetë; herë tjetër vijnë pas darke. Ose shkoj në teatër a në kinema me miq, gjithmonë të njëjtët. Por zakonisht shoh televizor.
- Ah, ke blerë televizor? Nuk e dija.
- Ah, nuk ta kam thënë? Po, e kam vënë lart, në një sallon. Vjen një familje që banon këtu afër dhe e shohim bashkë. Ose e shoh vetëm. Më pëlqen televizori: është më mirë se kinemaja: s'ke pse del nga shtëpia, mund



ta shohësh në një kolltuk të rehatshëm e të bësh edhe diçka tjetër njëkohësisht. E di që kam filluar sërish të punoj me shtiza? Kisha vite që nuk punoja më. Tani po bëj një triko.

- Po pas televizorit çfarë bën?

- Bie të fle. Ç'të bëj sipas teje?

- E po, mund të lexosh, për shembull.

- Po, lexoj, patjetër, që të më vijë gjumë. Tani, për shembull, po lexoj një roman interesant.

- Kush e ka shkruar?

- Nuk e mbaj mend kush e ka shkruar, është roman amerikan. Tregon jetën në një qytet të vogël periferik.

- Ç'titull ka?

E pashë të merrte një shprehje pasigurie dhe shtova vrik:

- Harrova që gjithë jetën nuk e ke mbajtur mend kurrë as autorin, as titullin e librit që lexoje. Apo s'është kështu? Ndoshta fola me ton të butë; dhe, sidoqoftë, i bëhej qejfi që mbaja mend diçka që kishte lidhje me të. Buzëqeshi modeste:

- S'është ashtu. Vetëm se, disa emra është e vështirë t'i mbash mend. Pastaj unë dua kryesisht të kaloj kohën. Një autor apo një tjetër, për mua s'ka rëndësi.

- E drejtë. Vazhdon të pish kamomil përpara se të flesh?

- Si ka mundësi që e mban mend? Po, pi akoma.

- Ta sjellin në dhomë? Ta lënë mbi komodinë?

Papritur heshta, me një ndjesi ngopjeje dhe kotësie. Mund të vazhdoja, siç mendova, të vazhdoja të pyesja me orë të tëra mamanë, e prapë s'do të kisha zgjidhur

gjë: jeta e saj si dhe ajo vetë kishin mbërritur tashmë sinorin e mungesës së plotë të domethënies që, në fund, është një lloj misteri njëkohësisht i pakuptimtë e i padepërtueshëm. Pastaj mamaja pyeti:

- Mbarove me pyetësin? Apo do të dish edhe ç'ëndrra shoh kur fle?

- Jam i kënaqur edhe me kaq.

Sërisht heshtje. Pastaj mamaja tha në mënyrë të papritur:

- Mamaja jote është një grua që jeton vetëm, veç ty të ka dhe është e lumtur që po vjen të jetosh me të.

Kuptova se ishte e mallëngjyer ngase po fliste për veten në vetën e tretë. Mendova t'i thosha edhe unë diçka të dashur, po nuk më erdhi kurrëgjë në mend. Për fat, Rita më zgjati në atë çast tabakanë me një ëmbëlsirë të rafinuar që e kundrova me admirim të shtirë, duke thënë:

- Ç'ëmbëlsirë e bukur.

- Është ëmbëlsira që të pëlqente më shumë.

Më shërbeu; Rita, siç vura re, qëndronte disi larg tavolinës. Nuk po kuptoja në e bënte për zemërim a për atë spitullimin e veçantë që shtiret si zemërim. Mamaja, që nuk e kishte prekur ëmbëlsirën, më vështroi ngultas e paepshëm gjatë gjithë kohës që po e haja. Në fund i bëri një shenjë Ritës, që unë nuk e kuptova. Vajza doli dhe pas pak u rishfaq me një kovë ku kishte zhytur një shishe shampanje.

- Tani do të pimë një gotë shampanjë për shëndetin tënd.

Pashë Ritën, me gjeste që tregonin shprehi të vjetra, të nxjerrë shishen nga kova, të çmbledhë letrën e

argjendte dhe te heqe tapen e madhe gati pa zhurmë e pa shkumë. E shtiu shampanjen në gotat tona dhe pastaj, si për të mos shqetësuar me praninë e saj ritin e krenimit tonë, doli vrik.

Ja ku isha, pra, me një gotë shampanjë në dorë, në këmbë, përballë nënës sime, e cila, edhe ajo në këmbë, më zgjaste gotën e saj. Shqiptova, duke mos ditur çfarë të thosha:

- Edhe njëqind ditë të tilla!

Mamaja qeshi:

- Duhet të ta them unë ty. Po harron se është festa jote, jo imja.

Nuk munda të mos përgjigjem:

- Festa e vërtetë është kjo e jotja: nuk pikturoj më, po kthehem në shtëpi me ty, pra: edhe njëqind ditë të tilla. Dhe me gotën time i mëshova gotës së mamasë, që këtë herë u hoq sikur nuk kishte dëgjuar. Më pas, pasi kishte pirë, duke vendosur gotën mbi tavolinë, tha:

- Nuk është e ftohtë aq sa duhet.

- Pse? Mua mirë më duket.

- Po, por nuk ka ndenjur mjaftueshëm në akull.

Mori sërish gotën dhe e ktheu me fund. Pastaj i ra një zileje mbi tavolinë. U shfaq sërish Rita. Mamaja ia përsëriti vërejtjen për shampanjen jo aq të ftohtë, pa marrë dhe pa pritur asnjë përgjigje në dukje. Pastaj shtoi se do ta pinim kafënë në studio. Dreka kishte mbaruar.

Dolëm nga salla e ngrënies dhe shkua në studio, një dhomë jo e madhe që zinte gjithë kthinën e katit përdhes. Në këtë studio unë nuk shkoja me kënaqësi, madje e shmangia qëllimisht, sepse, siç mendoja

shpeshherë, ishte një lloj tempulli për një fe që, pa dyshim, nuk ishte imja. Kështu, në studio, ulur në një karrige lëkure me tokëza të arta, përballë një tavoline të madhe baroke me dru lisi të gdhendur, me një sfond raftesh ku ishin rreshtuar pak libra dhe shumë blloqe shënimesh, mamaja i përkushtohej, vetëm apo në shoqëri të njerëzve të besuar, ritualeve, aq mallëngjyese për të, të mbarëvajtjes së punëve. Edhe atë ditë nuk munda të mos pyesja: “Pse këtu, nuk mund të shkojmë në sallon?”.

Mamaja sikur nuk më dëgjoi. E pashë të rehatohej pas tavolinës duke më bërë shenjë të ulesha përballë, në karrigen ku zakonisht uleshin bashkëbiseduesit e saj gjatë takimeve të punës. Më pas kërkoi në çantë, nxori një çelës, u tërhoq disi prapa, hapi një sirtar dhe mori një bllok të zi e të gjatë, që më bëri përshtypje se më ngjau si send kishtar ose, gjithsesi, me njëfarë lidhjeje me fenë. Në fakt, siç kujtova papritur, ishte blloku ku ishin shënuar, të renditura bukur, të gjitha pronat tona. Mamaja mbylli sirtarin, vendosi bllokun mbi tavolinën përpara vetes, më vështrroi një çast, ngultas, me sytë më të qelqtë se asnjëherë tjetër, e pastaj më tha:

- Pak më parë më pyete a jemi të pasur, e unë vendosa mos të të përgjigjem në prani të kamerieres. Por prapë më gëzon që më bën këtë pyetje. Tani do të ta jap të gjithë informacionin që dëshiron, duke qenë se, - shtoi këtë herë me zë të arsyeshëm, - është dëshira ime që të më ndihmosh me administrimin, t’ia marrësh dorën e të më zëvendësosh për shumë gjëra. Meqë nuk pikturon më, do të kesh mjaftueshëm kohë për ta bërë.

Nuk munda të mos rrëqethem prej këtyre fjalëve të fundit: me çfarë qetësie, me çfarë vetëkënaqësie i kishte shqiptuar mamaja atol “Meqë nuk pikturon më”; pa kuptuar se, për mua, ishte sikur të dëgjoja: “meqë nuk jeton më”. Këtë herë pyeta mundimshëm, pa kurrfarë keqdashjeje:

- Hë, pra, jemi të pasur apo jo?

E pashë të heshtë për një çast, tek më shihte me solemnitet të pazakontë. Pastaj, duke u zgjatur drejt meje e duke ulur zërin:

- Ne nuk jemi të pasur, Dino, jemi shumë të pasur. Falë mamasë tënde, ti je sot një burrë shumë i pasur.

- Ç’do të thotë, shumë të pasur?

- Shumë të pasur do të thotë diçka më shumë se thjesht të pasur.

- Por më pak se tepër të pasur?

- Po, më pak se tepër të pasur.

Tashmë mamaja më përgjigjej disi e pavëmendshme. Kishte rrokur një palë syze prej murgeshe, pa rrrathë e me bishta të artë, dhe shfletonte faqet e bllokut të zi:

- Kuptohet se s’ka më mirë se shifrat për të kuptuar, atëherë, atëherë, ku është, ah, po, për të kuptuar, po thosha, ç’do të thotë të jesh shumë i pasur.

Kuptova se tani do të më jepte informatat që më kish premtuar dhe papritur ndjeva një krupë të papërmbajtshme. Thirra me gjallëri:

- Jo, larg qoftë, nuk dua kurrsesi të di çfarë do të thotë të jesh shumë i pasur. Ta besoj fjalën.

Mamaja ngriti sytë nga blloku, hoqi syzet, dhe më vështroi.

- Ti duhet të dish, në mos për arsye tjetër, që të më ndihmosh me administrimin. Isha gati të thërrisja, dhunshëm: “Po unë nuk doja të të ndihmoja me administrimin”, kur fatmirësisht hyri Rita me tabakanë e kafesë. Me të parë Ritën u duk sikur mamasë iu kthjellua mendja, bash si një prift kur sheh të afrohet një i pafe. E mbylli me një lëvizje të prerë bllokun dhe tha:

- Shërbejeni ju kafenë, Rita. Atëherë, ndërsa Rita, në këmbë krahe meje, shtinte kafenë në filxhanë, unë mendoja si të shpëtoja nga kjo gjë e padurueshme: shpjegimi i të qenët shumë i pasur. Rita më qëndronte afër, tani, dhe, nuk e kuptova a e bëri me qëllim apo jo, më preku gjurin me njëren këmbë. Pastaj u kthye nga unë dhe më zgjati filxhanin tim. Gati instinktivisht, i dhashë një shtysë krahut. Filxhani u kthye në pjatë dhe kafeja ra mbi pantallonat e mia me ngjyrë të hapur, e ngrohtë dhe e lagësht në lëkurë. Grafullova me lebeti të shtirur:

- Pantallonat, e marrtë dreqi!

- Rita, pse nuk ke kujdes? - e qortoi mamaja, që nuk kishte parë e kuptuar asgjë.

- S'ka faj Rita, e derdha unë, - nxitova të thosha. - Puna është se m'u bënë pis pantallonat.

- S'ka gjë, - tha Rita, - ishte pa sheqer, po sjell pak ujë që ta heq njollën.

Kjo zgjidhje nuk i pëlqeu mamasë, e cila kundërshtoi me zërin më të papëlqyeshëm dhe me ton autoritar:

- Aspak, nuk u pastrohen në trup njollat njerëzve. Zoti Dino do të heqë pantallonat, ju do të hiqni njollën e pastaj do t'i hekurosni.

Pashë Ritën ndërsa qëndronte në këmbë pranë tavolinës dhe fytyra i kish marrë një shprehje durimi servil; pastaj pyeti me seriozitet:

- Zoti Dino do t'i heq menjëherë pantallonat, apo më duhet të pres?

- Kafeja lë njollë, - tha mamaja, - më mirë hiqi menjëherë, Dino.

- S'mund t'i heq këtu në sallon.

Pashë Ritën të kthente kokën në krahun tjetër, ndoshta për të fshehur një buzëqeshje.

- Shko lart, - tha mamaja, - në dhomën tënde, hiq pantallonat dhe jepja Ritës. Pastaj vish penjuarin që ke në dollap dhe eja këtu. Unë po bëj gati disa dokumente që dua t'i shohësh.

Kështu dolëm, unë dhe Rita, e cila më paraprinte gati ngarendas, duke thënë:

- Shikoni, po shkoj përpara, sepse ajo dhomë ka qenë e mbyllur, të paktën të hap dritaret, dhe unë duke e ndjekur e duke menduar, me njëfarë çmeritjeje, që gjithçka zhvillohej sipas rregullave të pashkruara, por të paepshme të situatave të ngjashme me rrogëtësia: nëna që i ofron të birit, vetë ajo, shkakun për t'u veçuar me kamerieren; kjo e fundit dhe biri që i aviten së bashku shtratit ku do të bien bashkë, duke u shtirur me njëri-tjetrin se po marrin seriozisht shkakun e ofruar nga mamaja; kamerierja në të njëjtën kohë e eksituar dhe ambicioze servile; biri, edhe ai njëkohësisht i eksituar dhe zotërisht i poshtëruar. Ndër këto mendime mbërrita në katin e dytë dhe shkova drejt dhomës ku më kishte paraprirë Rita. E pashë të zgjatej në dritare për të hapur

grilat; me t'u kthyer nga unë, pak e skuqur në fytyrë nga mundimi, nxitimi dhe, ndoshta, nga trazimi, i thashë preras:

- Prisni pak jashtë, derisa t'ju thërras.

Sapo doli, u afrova ngadalë në dritare e për një çast qëndrova në këmbë, mbështetur në kanat, duke vështruar si në zhgjëndërr kopshtin me stil italian që shtrihej poshtë. Nuk e kam zakon të kujtoj të shkuarën, as të mallëngjehem në vendet e së shkuarës; por atë ditë kisha vendosur të kthehesha në shtëpi me mamanë, pas dhjetë viteve mungesë; kështu nuk mund të mos krahasoja gjendjen time shpirtërore të çastit me atë të dhjetë viteve më parë. Atëherë, në fillim me shikim nga mobiliet me stil perandorak në dhomë e pastaj nga format gjeometrike të kopshtit me stil italian, të gjitha të pandryshuara, ndjeva nuk e di çfarë lehtësimi të gërditshëm nga mendimi se, tekefundit, as unë nuk kisha ndryshuar. Po, nuk kisha ndryshuar; dhe tani po kthehesha në shtëpi me mamanë, për t'iu rikthyer zakoneve të vjetra të para dhjetë vjetëve e, ndoshta, dalëngadalë, mund të filloja sërish pikturën te studioja teposhtë, në fund të kopshtit, edhe ajo e pandryshuar. Kushedi, ndoshta, siç më kish ndihmuar asokohe shpërngulja në rrugën “Margutta” për të pasur besim në punën time, kështu, tani, kthimi në vilën e mamasë do të më shpërfaqte sërish, qoftë edhe për pak kohë, iluzionin e pikturës: jeta, tekefundit, ishte pikërisht një ndryshim i vazhdueshëm i vendndodhjes, si në një krevat të parchatshëm ku është e pamundur të flesh gjatë në të njëjtin krah. Por sapo ktheva vështrimin drejt



krevatit dhe pashë që nuk kishte mbulesa apo çarçafë dhe dysheku ishte i mbështjellë, siç bëhet në dhomat e pabanuara, vura re papritur se kjo pandryshueshmëri e gjërave dhe e vetes sime nuk ishte dhe aq pozitive, siç më ishte dukur për një çast. Vërtet, asgjë s'kishte ndryshuar, por unë do të përballesha sërish me dëshpërimin, edhe ky i pandryshuar, që, asokohe, më kishte shtyrë të largohesha nga shtëpia. Asgjë s'kishte ndryshuar, po ngase koha nuk kalonte pa lënë gjurmë, çdo gjë ishte përkeqësuar nga pak, edhe duke qëndruar e palëvizshme. Kështu, ndërsa mamaja më priste poshtë në sallon për të më shpjeguar, me letra në dorë, çfarë do të thotë të jesh i pasur, Rita priste pas dere që ta thërrisja të hynte e t'i hidhesha sipër: dy gjëra në dukje shumë larg njëra-tjetrës, në të vërtetë të ngërthyera nga një mekanizëm i fshehtë dhe i përpiktë. Këtë mekanizëm nuk e kisha të panjohur, ia kisha nuhatur ngaherë ekzistencën, por nuk e kisha parë kurrë kaq kthjellët sa tani, ashtu siç mund të shihet prerja e motorit të aeroplanit në vitrinat e kompanive ajrore, me gjithë pajisjet e tij të shumta e të ndërlikuara. Ishte, pra, mekanizmi i dëshpërimit që, sikur të kthehesha në shtëpi me mamanë, do të më hidhte nga pasuria në impotencë, nga kjo te mërzia e nga mërzia te Rita, ose te cilido angështim i së njëjtës natyrë. Më mirë atëherë të kthehesha në studion në rrugën "Margutta", ku dëshpërimi, të paktën, shprehej në kanavacën e pastër që nuk do ta pikturoja kurrë.

Dëgjova në këtë çast një kruajtje të kujdesshme, por dukshëm të paduruar, në derë; e përpara se ta kuptoja se çfarë po bëja, kisha liruar rripin, kisha hequr pantallonat

e pastaj kisha shtjellë jorganin e isha shtrirë në shpinë mbi krevat. Kështu e thirra Ritën të hynte.

Hyri menjëherë, u sigurua me një shikim të shpejtë që isha shtrirë, dhe u kthye të mbyllte derën. Unë qëndrova pa lëvizur gjatë gjithë kohës, përpos vendit ku dëshira bënte të vërshonte gjaku i trazuar: më shikonte barkun me sytë ngultas, mjekrën e palëvizshme mbi gjoks, si një kufomë e shtrirë në tabut që duket sikur shikon trupin e vet të përgatitur për ta çuar në varrezë. Rita, ndërkohë, kishte ardhur afër krevatit e, duke qëndruar në këmbë, dukej sikur më vështronte përmes gjyzykëve të saj hipokritë, siç shihet një send i panjohur e që meriton vëmendje. Atëherë zgjata njërën dorë, i kapa dorën që linte të varej përgjatë ijës dhe e tërhoqa siç tërhiqet nga kapistra një kafshë më shumë e trembur se e pabindur; dhe ndjeva se gjithë trupi i saj ndoqi atë dorë. Ia çova dorën drejt qendrës së trupit tim dhe, sapo pata sigurinë se ishte mbledhur grusht, ia lëshova. Tani Rita qëndronte e ngurrët, disi e përkulur përpara, me krahun e zgjatur mbi trupin tim, një të kuq të ndezur nën dy rrathët e zinj të syzeve. Pastaj, çuditërisht, tha me zë të ngadaltë e të vetëkënaqur:

- Sa e shpifur! U habita, pasi ishin të njëjtat fjalë që do të kisha thënë vetë unë, po të kisha dashur të shprehja ndjesinë e përzier mes neverisë dhe eksitimit që ndieja në atë çast.

Pas një frymëmarrjeje të thellë, pa e parë, e pyeta me zë të ulët:

- Pse erdhe këtu?

Ngriti supet e nuk tha asgjë; dukej e paaftë për të folur.

- Për të më hequr njollën? Atëherë, shko hiqe, ç'pret?

E pashë të zmbrapsej, si ta kisha goditur në fytyrë, të hapte gishtat me ngurrim, njëri pas tjetrit, e pastaj të largohej nga shikimi im. Iu desh të dilte edhe nga dhoma, ngase, pas një çasti, dëgjova zhurmën e derës që hapej e mbyllej. Sapo u sigurova se ishte larguar, zbrita nga krevati dhe hapa dollapin. Siç e dija, pranë penjuarit prej mëndafshi që, sipas këshillës së mamasë, duhet të vishja, varej i mbështjellë në celofan, i vetmi kostum që nuk kisha marrë me vete kur shkova të jetoja në studio: smokingu. Mora pantallonat dhe i vasha. Nuk më rrinin keq, ndoshta pak të gjera, dhjetë vjet më parë kisha qenë më i shëndoshë, kuzhina e mamasë ishte më e pasur dhe më e ushqyeshme se ajo e tavernave ku shkoja tani. U pashë në pasqyrë: me xhaketen e kërpit ngjyrë kafe mbi pantallona të zeza dukesha si kamerier i papunë. Hapa ngadalë derën, pashë që nuk kishte njeri, zbrita me nxitim shkallët, e pastaj në korridor, duke shmangur sallonet, hyra në paradhomë e nga këtu dola në sheshpushim.

Dy makinat, ajo e vjetra dhe e reja, qëndronin njëra krah tjetrës, përballë vilës. Qielli i bruztë, pemët, vila pasqyroheshin vagullt në shkëlqimin e kthjellët të karrocërisë së makinës së re; ndërsa e vjetra dukej e lëbyrtë, me të njëjtën lëbyrësi, nuk munda të mos e mendoja, me të cilën mërzia zakonisht mbulonte botën rreth meje. Grisa një faqe nga blloku im, shkrova mbi të: “Faleminderit, por dua të mbaj makinën e vjetër. Djali

yt që të do shumë, Dino”, dhe e vendosa nën fshirëset e xhamit, atje ku, zakonisht, policët vendosin fletushkat e gjobave. Pastaj hipa në makinë, ndeza motorin dhe u nisa.

## KAPITULLI I DYTË

Në të njëjtën ndërtesë në rrugën “Margutta” ku banoja, në korridorin e katit përdhes, tri dyer më tutje nga unë kishte studion një piktor i vjetër që quhej Balestrieri. E takoja shpesh, kisha shkëmbyer ndonjë fjalë me të, por nuk shoqëroheshim bashkë: si të gjithë burrat që e kanë mendjen vetëm te gratë, Balestrieri kishte një ftohtësi të skajshme e gati fyese me njerëzit e të njëjtit seks, cilado qofshin kushtet a moshën, me sa duket, sepse përshquante tek ata po aq rivalë të mundshëm. Balestrieri ishte një burrë i vogël, me shpatulla tejet të gjera e me këmbë shumë të mëdha, dy të meta që nuk përpiqej t’i fshihte, përkundrazi, i vinte në dukje duke veshur xhaketa të stërmëdha sportive me kuadrate e duke mbathur këpuçë të vjetra me shkëlqim e me majë. Fytyra e Balestrierit kishte diçka prej maske karnavalesh ose prej gjysmëperëndie pylli pompeian: flokë të thinjur të argjendtë, fytyrë e kuqe e ndezur, vetulla të zeza si qymyr, hundë të kërcyer, gojë të madhe, mjekër me majë. Shprehja e kësaj fytyre

ishite disa e çoroditur e, megjithatë, në të vërtetë, edhe e turbulluar. Për Balestrierin kisha dëgjuar nga disa piktorë të moshuar që e njihnin mirë se ishte erotoman dhe se e kishte filluar pikturën që në të ri vetëm për të tërhequr gratë në studion e tij, me pretekstin e pikturës, që, për të, ishte kryekreje nudoja femërore. Balestrieri, gjithmonë i paqetë, nuk jetonte me punën e tij, nuk ekspozonte kurrë dhe, në njëfarë mënyre, pikturonte vetëm për veten; miqtë e tij më thanë se ishte kaq i lidhur me pikturat e tij, saqë, ato të rrallat, kur vendoste të të dhuronte ndonjë, bënte një kopje dhe e jepte në vend të origjinalit. Për sa i përket cilësisë, të gjithë ishin dakord se kishin të bënin me pikturë të dobët. Një a dy herë, nga kureshtja, isha munduar t'u hidhja një sy pikturave të Balestrierit nga xhamat e dritares së tij, në oborr; kisha përshquar disa kanavaca të mëdha të errëta ku dalloheshin me vështirësi nudo të stërmëdha femërore me forma të tepruara e qëndrime aspak të natyrshme.

Studioja e Balestrierit vizitohej vazhdimisht nga shumë gra. Nga xhamat e dritares sime mund t'i shihja teksa përshkonin oborrin e zhdukeshin në derën që shihte nga korridori i katit përdhes. E dija se shkonin te Balestrieri, sepse në të dyja studiot e tjera banonin dy piktorë që jetonin me familjet e tyre dhe, për më tepër, nuk punonin me modele, sepse pikturonin tablo abstrakte. Te gratë e Balestrierit gjeronte një larmi e tërë shijesh: të reja dhe në moshë, të thjeshta dhe zonja, vajza dhe të martuara, brune dhe flokëverdha, të dobëta dhe të shëndosha, të vogla dhe të mëdha, dukej